

# EFIKASITETI GJYQËSOR NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT NË "SHTETIN E ROBËRUAR"

RAPORTI I PROJEKTIT MONITORIMI I RASTEVE GJYQËSORE NË FUSHËN E KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT SIPAS LIGJIT TË RI PËR PROCEDURË PENALE PËR 2016



*Projekti i financuar nga ana e Departamentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës – Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shkup, Byroja për Luftë Ndërkombëtare Kundër Narkotikëve dhe Zbatimi i Ligjit.*



Përmbajtja dhe konkluzionet në këtë publikim nuk i paraqesin qëndrimet e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shkup, Byronë për Luftë Ndërkombëtare kundër Narkotikëve dhe Zbatimin e Ligjit.

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

343.352:343.9.02]:347.96/.99.077.1(497.7)"2016"(047)

BOGDANOVSKA, Aleksandra

Efikasiteti gjyqësor në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në "Shtetin e robëruar : monitorim i proceseve gjyqësore nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit sipas ligjit të ri për procedurë penale / [Aleksandra Bogdanovska ; përkthuer Slavica Dimitrievska]. - Shkup : Koalicioni i shoqatave të qytetarëve "Të gjithë për gjykim të drejtë", 2016. - 52 str. : граф. прикази ; 21

CM

Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 51-52

ISBN 978-608-4552-37-6

а) Корупција - Организиран криминал - Судство - Независност -

Македонија - 2016

COBISS.MK-ID 102184202

# EFIKASITETI GJYQËSOR NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT NË **“SHTETIN E ROBËRUAR”**

Botues: Koalicioni i shoqatave të qytetarëve  
**„Të gjithë për gjykim të drejtë“**  
Rr.Makedonija 11/2-10, 1000 Shkup  
Tel/Fax: +389 2 6139874  
E-mail: [contact@all4fairtrials.org.mk](mailto:contact@all4fairtrials.org.mk)  
Web: [www.all4fairtrials.org.mk](http://www.all4fairtrials.org.mk)

Për botuesin: Dr.Mirjana Ivanova Bojaxhievska,  
Drejtor ekzekutiv

Autor: Mr. Aleksandra Bogdanovska  
Drejtor ekzekutiv

Redaktor: Mr. Aleksandra Bogdanovska  
Drejtor ekzekutiv

Implementues: Koalicioni „Të gjithë për gjykim të drejtë“

Bashkëpunëtorë: Daniell Mitkovski,  
Asistent proektues

Avokat Natali Petrovska,  
Avokat Vladimir Andreevski,  
Borçe Gavrilovski,  
Darko Avramovski,  
Mishell Siljanovski,  
Vëzhgues

Përkthim: Ardian Saliu

Dizajni dhe vula: Grafohartija

Tirazh: 50

## LISTA E SHKURTESAVE TË PËRDORURA MË SHPESH

GREKO Grupi Monitorues i Shteteve Kundër Korrupsionit pranë Këshillit të Evropës

KEDNJ Konventa Evropiane për të Drejtat e njeriut

BE Bashkimi Evropian

LPP Ligji për Procedurën Penale

KP Kodi Penal

PNDQP Pakti Ndërkombëtarë për të Drejtat Qytetare dhe Politike

PPK Prokurori Publik Kryesor/Prokuroria

RM Republika e Maqedonisë

PSP Prokuroria Speciale Publike

PËRMBAJTJA	
FALENDERIM.....	2
HYRJE .....	3
<b>PËR KOALICION “TË GJITHË PËRGJYKIM TË DREJTË” .....</b>	<b>7</b>
1. LËNDA, QËLLIMET DHE METODOLOGJIA E HULUMTIMIT.....	8
1.1. LËNDA E HULUMTIMIT .....	8
1.2. QËLLIMET E HULUMTIMIT .....	10
1.3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT .....	11
2. ANALIZA E REZULTATEVE NGA VËZHGIMI I LËNDËVE NGA FUSHA KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT .....	13
2.1. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME .....	13
2.1.1. Aplikimi i procedurës së shkurtuar .....	16
2.1.2. Gjykimi publik.....	16
2.1.3. Përgatitja dhe kushtet për mbajtjen e seancës kryesore.....	18
2.1.4. Fjalimi hyrës .....	22
2.1.5. Të drejtat e personit të akuzuar .....	23
2.1.6. Pranimi i fajësisë.....	26
2.2. SEANCA DËSHMUESE .....	28
2.2.1. Renditja e paraqitjes së provave .....	28
2.2.2. Testimi i drejtpërdrejtë, i kryqëzuar dhe shtesë .....	29
2.2.3. Lejueshmëria e pyetjeve dhe ankesave.....	32
2.2.4. Barazia e armëve.....	33
2.2.5. Ekzaminimi i të akuzuarit.....	35
2.2.6. Mënyra e paraqitjes së dëshmive materiale dhe atyre me shkrim .....	36
2.2.7. Mënyra e regjistrimit të rrjedhës dhe paraqitjes së dëshmive .....	37
2.2.8. Gjykimi i paanshëm.....	38
3. ANALIZË E POLITIKËS DËNUESE .....	39
4. PËRFUNDIMET GJENERALE .....	44
5. REKOMANDIMET .....	45
Për shtetin.....	45
Për donatorët dhe organet shtetërore .....	45
Për punën e gjykatave, prokurorinë dhe avokatët .....	45
6. LITERATURA E PËRDORUR .....	47

## FALENDERIM

Të nderuar,

Koalicioni **“Të gjithë për Gjykim të Drejtë”** u prezanton edhe një analizë të projektit **“Vëzhgimi i Proceseve Gjyqësore nga Fusha e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit sipas Ligjit të Ri për Procedurë Penale”**, i cili është i fokusuar në çështjet që e trajtojnë problematikën e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit si dhe zbatimin e Ligjit të Ri për Procedurë Penale.

Në analizën janë të mbledhura të dhënat nga monitorimi i lëndëve gjatë vitit 2016 nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit përpara departamentit për krim të organizuar dhe korrupsion, lëndë me rëndësi për publikun dhe mostër e përzgjedhur nga lëndët tjera të korrupsionit, ndërsa në bazë të këtyre të dhënave i rishikuar çështjet për pavarësinë, efikasitetin dhe paanshmërinë e gjyqësorit të Maqedonisë në luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe vlerësimin e implementimit të duhur të reformave penale-ligjore me fokus kryesor në Ligjin e Ri për Procedurë Penale.

Personi përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve të projektit, analizimin e të dhënave të marra dhe në pjesë më të madhe për përpunimin e analizës është Drejtori Ekzekutiv – Aleksandra Bogdanovska, e cila pa rezervë i meritoi kritikën pozitive. Tërë procesi ishte mbështetur pa egoizëm me angazhimin profesional të asistentit të projektit Daniell Mitkovski, veçanërisht në pjesën përpunimi i data-base-it, si dhe me vëzhguesit/et që ishin të përfshirë drejtpërdrejtë në monitorimin e lëndëve dhe pa kontributin e të cilëve kjo analizë do të ishte jo e plotë.

Dua të shpreh falënderim të përzemërt për Departamentin Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës – Ambasadën e Shteteve të Bashkuara – Biron për Luftë Ndërkombëtare Kundër Narkotikëve dhe Zbatimin e Ligjit, sugjerimet e të cilëve gjatë realizimit të aktiviteteve të projektit dhanë një kontribut kualitativ drejt produktit përfundimtar të projektit, si dhe për mbështetjen financiare dhe bashkëpunimin e suksesshëm që nga viti 2004 e deri më sot.

*Dr. Mirjana Ivanova Bojaxhieva  
Kryetare e Koalicionit“  
Të gjithë për gjykim të drejtë”*

## HYRJE

Koalicioni “**Të Gjithë për Gjykim të Drejtë**” paraqet organizim në të cilën marrin pjesë organizatat qytetare nga gjithë territori i Republikës së Maqedonisë. Misioni kryesorë deri në ekzistimin e tanishëm është monitorimi i respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut veçanërisht në standardet ndërkombëtare për gjykim të drejtë nëpërmjet formave të ndryshme të veprimit.

Duke zhvilluar një program për vëzhgim të lëndëve gjyqësore në lidhje me korrupsionin, koalicioni në vitin 2007 filloi një pilot fazë gjashtë mujore të emëruar si “**Vlerësimi i nevojave për zhvillim të programës për monitorim të procedurave gjyqësore në lidhje me korrupsionin në RM**”. Me këtë pilot projekt të parë u mblodhën materiale empirike në bazë të së cilave në sipërfaqe dolën shumë probleme me të cilat ballafaqohen organet e zbatimit të ligjit gjatë punës me lëndët që kanë lidhje me korrupsionin. Në kornizat e këtij pilot projekti ishte bërë definimi i veprave kriminale që kanë lidhje me korrupsionin në aspektin e legjislacionit dhe praktikës gjyqësore. Definimi përfundimtar kishte gjetur 24 vepra penale të cilat janë në korrelacion të drejtpërdrejtë me korrupsionin.<sup>1</sup> Që nga viti 2012 e deri më sot vazhdojnë projekte të zbatuara ekskluzivisht në territorin e Gjykatës Themelore Shkupi 1 Shkupi në krahasim me vitet e kaluara kur monitorimi kryhej në gjithë territorin e shtetit. Kjo është për shkak se atëherë për herë të parë ishte themeluar Departament për ndjekjen e veprave penale nga fusha e krimit të organizuar, ku përfshihet edhe korrupsioni me të gjitha format e tij të manifestimit.

Pas formimit të këtij Departamenti, dhe gjatë monitorimit të lëndëve me karakter më të vështirë ishte vërejtur rritje e konsiderueshme e shkëljes së të drejtave të njeriut të personave të akuzuar, veçanërisht e drejta e lirisë me përcaktimin e paraburgimit pa asnjë grimë në çdo akuzë. Sidomos kohët e fundit për të shënuar është fakti se nga ana e gjykatave konstatohet ky lëndim dhe për këtë arsye më shumë e më shumë shkon drejt asaj që paraburgimi të zëvendësohet arrestimin shtëpiak. Kjo është për shkak se të pandehurit janë në dispozicion për organet e zbatimit të ligjit, ndërsa të drejtat e tyre për liri janë në masë minimale të kufizuara. Të pandehurit edhe më tej mbeten në rrethin e familjeve të tyre.

Çështjet që kanë të bëjnë me korrupsionin, krimin e organizuar si dhe me respektimin e parimeve për gjykim fer dhe të drejtë janë të theksuara edhe në dokumentet

---

<sup>1</sup> *Ryshfjet gjatë zgjedhjeve dhe votimit, mashtrim, mashtrim i blerësve, pranim i paautorizuar i dhuratave, falimentim i rrejshëm, shkaktimi i falimentimit me punë të pandërgjegjshme, keqpërdorim i procedurës për falimentim, dëmtimi ose privilegjimi i kreditorëve, larja e parave dhe të ardhurave tjera nga krimi, mashtrimi gjatë punës me letra me vlerë dhe aksione, zbulimi dhe marrja e paautorizuar e një sekreti afarist, keqpërdorimi i pozitës zyrtare dhe autoritetit, keqpërdorim gjatë kryerjes detyrës, mashtrim gjatë kryerjes detyrës, përvetësim gjatë kryerjes së shërbimit, marrja e rryshfetit, dhënia e rryshfetit, ndërmjetësim i paligjshëm, fshehja e origjinës së pasurisë përfituar në mënyrë disproporcionale, zbulimi i sekretit zyrtar, keqpërdorimi i një sekreti shtetëror, zyrtar ose ushtarak, falsifikimi i dokumentit zyrtar, pagesat jashtëligjore, si dhe ndikimi i jashtëligjshëm ndaj dëshmitarëve.*



kryesore që janë të rëndësishme për R.M., pikërisht prioritetet urgjente reformuese të përcaktuara nga Komisioni Evropian<sup>2</sup>, Dialogu Qasës i nivelit të lartë mes Maqedonisë dhe Komisionit Evropian<sup>3</sup>, Raporti i Komisionit Evropian për Përparimin e Maqedonisë për vitin<sup>4</sup> 2016 dhe Rekomandimet e grupit të ekspertëve me përvojë për çështjet sistematike të sundimit të ligjit në lidhje me përgjimin e telekomunikacioneve të zbuluara në pranverë të vitit 2015 (njëkohësisht të njohura si Raporti i Pribe-s)<sup>5</sup>.

**Viti i kaluar 2016 ishte vit edhe i një analize të projektit “Monitorimi i Lëndëve Gjyqësore nga Fusha e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit sipas Ligjit të Ri për Procedurë penale” i cili është i fokusuar në çështjet të cilat e trajtojnë problematikën gjyqësore gjatë vendosjes së lëndëve nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit, por edhe të gjitha reformat mbështetëse dhe aktualitetet që kanë të bëjnë me gjyqësorin në përgjithësi.**

Përmes monitorimit të procedurave gjyqësore nga ana e vëzhguesve gjyqësor me eksperiencë janë marrë të dhëna statistikore për aktivitetet e organeve të zbatimit të ligjit, veçanërisht nga Prokurorët Publik si parashtrues të akuzave të cilat duhet të jenë përgatitura profesionalisht dhe teknikisht, të përmbajtura, të argumentuara me prova të mjaftueshme të pakundërshtueshme për kryesin dhe veprën.

Lidhur me rolin e gjykatave, gjegjësisht gjykatësve nisemi nga supozimi se ata në zbatimin e funksionit të tyre kryesor – sundimi i ligjit si vlerë themelore gjatë marrjes së vendimit për të punuar në kornizat e normave ligjore, të jetë bazë për krijimin e sigurisë ligjore të qytetarit dhe për stabilitetin dhe zhvillimin që bazohet në ligj. Nga kjo varret edhe besimi i qytetarëve në gjyqësorin, zbatimi i plotë i moralit gjyqësor dhe profesionalizmi i lartë do të krijojë një bazë sigurt dhe të fortë për rritjen e besimit të qytetarëve në gjyqësorin.

Parasëgjithash, korrupsioni është një dukuri e dëmshme shoqërore me ndikim të shprehur në zhvillimin e shoqërisë dhe është aq i vjetër sa shteti. Pa diskutim, korrupsioni është një dukuri komplekse që në fenomenologjinë krimnologjike dhe penale-juridike

---

<sup>2</sup> Urgent Reform Priorities For The Former Yugoslav Republic Of Macedonia, June 2015,

[www.ec.europa.eu/enlargement/news\\_corner/news/news-files/20150619\\_urgent\\_reform\\_priorities.pdf](http://www.ec.europa.eu/enlargement/news_corner/news/news-files/20150619_urgent_reform_priorities.pdf)

<sup>3</sup> Mbledhja e pestë e Dialogut Qasës në nivel të lartë mes Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit Evropian 18.09.2015.

<sup>4</sup> Commission Staff Working Document

The former Yugoslav Republic of Macedonia 2016 Report

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2016/20161109\\_report\\_the\\_former\\_yugoslav\\_republic\\_of\\_macedonia.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2016/20161109_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf)

<sup>5</sup> The former Yugoslav Republic of Macedonia: Recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues relating to the communications interception revealed in Spring 2015,

[www.ec.europa.eu/enlargement/news\\_corner/news/news-files/20150619\\_recommendations\\_of\\_the\\_senior\\_experts\\_group.pdf](http://www.ec.europa.eu/enlargement/news_corner/news/news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf)

paraqitet si një formë e veçantë e kriminalitetit, por edhe si një metodë e kryerjes së formave të tij më komplekse.

Kur bëhet fjalë për veprat penale nga fusha e korrupsionit më së pari mendojmë për veprat kundër detyrës zyrtare, që nënkupton të drejtat dhe detyrat e një personi të caktuar për të ndërmarrë veprime të caktuara të karakterit publik. Për këtë shkak mosrespektimi i tyre shkakton dëme për një subjekt të caktuar, gjegjësisht parasëgjithash dëme pëson shteti – qytetarët. Për realizim të suksesshëm të këtij projekti gjatë vëzhgimit të lëndëve të cilat janë në kontakt të shpeshtë me korrupsionin duhet të specifikohen karakteristikat e tyre, duke i identifikuar si individuale, përmes një objekti të veçantë për mbrojtje dhe në grup, përmes objektit të veçantë për mbrojtje. Gjatë kësaj shumë e rëndësishme është qasja metodologjike e cila do ta caktojë kualitetin e rezultateve të arritura, suksesin në depërtimin e dukurisë që hulumtohet me të gjitha karakteristikat e saj, gjetja e pikave të dobëta, pasi që më shpesh autorët janë persona me vende pune me përgjegjësi në organet shtetërore, shërbimet publike dhe institucione tjera dhe ata vendosin për të drejtat dhe obligime e qytetarëve dhe personave juridik. Efikasiteti i luftës kundër korrupsionit shkencërisht kërkon përdorimin e të gjitha mjeteve dhe metodave në dispozicion nga ato klasike (konvencionale) e deri tek më të rejat (bashkëkohoret).

Vëzhgimi i proceseve gjyqësore në lidhje me korrupsionin në Republikën e Maqedonisë nëpërmjet vëzhgimit bën analizën e procedurave gjyqësore nga fusha e korrupsionit edhe atë më shpesh lëndët penale, Shpërdorim të detyrës dhe autorizimit zyrtar dhe Mashttrim, të cilat më shpesh përsëriten në çdo hulumtim vjetor. Veprat tjera penale nga fusha e korrupsionit ose realisht kryhen më rrallë ose mënyra e kryerjes së tyre shkakton vështirësi në sigurimin e provave të nevojshme për verifikimin e gjendjes faktike. Kemi marrë përshtypjen se edhe organet e hetuesisë sikur kanë kapacitete për të trajtuar me efikasitet dy veprat e lartpërmendura penale.

Duke u nisur nga efektet e dëmshme të korrupsionit me hulumtim duhet të depërtohet sa më thellë në lëndët gjyqësore ku me vëzhgim të procedurës që nga fillimi e deri në fund të merret një pasqyrë e qartë për të gjitha segmentet e ngjarjes penale-ligjore nga pjesëmarrësit, autorët e veprës së korruptuar, niveli i tyre i arsimimit a është recidiv ose kundërvajtës, vendi i tij i punës – funksion që mundëson kryerjen e veprës së tillë, a bëhet fjalë për shërbim ose kundër shërbim edhe pse tek të dy rastet bazë është shpërdorimi pozitës dhe autorizimit zyrtar. Pastaj është e nevojshme që të ndiqet edhe vet rrjedha e procedurës në të gjitha fazat duke ndjekur aktivitetin e të gjitha subjekteve në procedurë. Vëzhgim të padisë e ngritur deri në momentin e miratimit të vendimit gjyqësor.

Sanksionet e vendosura janë një segment i rëndësishëm në këtë hulumtim, veçanërisht në aspektin e arritjes së qëllimit të dënimit, gjegjësisht në krahasim me dy vjet më parë se a ec politika penale përpara dhe a janë vendosur dënime më të rrepta (burg, gjoba, masa alternative) ose janë vendosur dënime më buta.

Tek ky lloj i veprave penale për shkak të specifikave të tyre veçanërisht duhet të analizohet praktika gjyqësore në lidhje me vendosjen e masës së veçantë penale-juridike, konfiskim i pronës dhe pasurisë. Konfiskim i pasurive të fituara nga krimi, të ardhurat nga krimi të cilat rrjedhin nga veprat penale përkatëse ose pronë e cila korrespondon nga të ardhurat e tilla ose konfiskimi i pronës, pajisjeve dhe mjeteve tjera që janë përdorur ose kanë të bëjnë me veprën e kryer. Kjo është veçanërisht e rëndësishme të përcaktohet pikërisht për shkak natyrës së këtij lloji të veprave penale.

Me vëzhgimet dhe të kuptuarit real të situatave, me këtë lloj të krimit si dhe me **aftësinë e gjyqësorit për t'u marrë me kryerësit e tillë në krahasim me shumë vite më pas** do të shihen rezultatet dhe progresi i pritur në punën e gjykatave me lëndët që kanë elemente të korrupsionit dhe do të arrihet përgjigja e pyetjes se a ka përmirësim dhe sukses në trajtimin e luftës kundër ndikimit të korrupsionit në punën e institucioneve.

Ky është **motivi që koalicioni “Të Gjithë Për Gjykim të Drejtë” edhe pas 9 viteve** të vazhdojë që me vëzhgimin e lëndëve gjyqësore të përcaktojë gjendjen e re, të sjell konkluzione dhe rezultate në bazë të vëzhgimit dhe situatës së konstatuar të ofrojë rekomandime dhe sugjerime për përforsimin e efikasitetit gjyqësor në luftë me këtë dukuri të dëmshme shoqërore.

Koalicioni **“Të Gjithë për gjykim të drejtë” me specifikat e qëllimeve të veta të** ekzistimit dhe aktivitetet që i kryen, megjithëse vepron vetëvetiu nëpërmjet projekteve të përmendura, vepron edhe në rrjet me koalicione dhe partneritete tjera të cilat gjithashtu i trajtojnë çështjet e korrupsionit. Pjesëmarrja në kësaj formë të bashkuara të aktiviteteve të koordinuara krijon hapësirë për ndikim më të madh në rezultatet dhe të dhënat deri tek cilat vjen Koalicioni nëpërmjet punës që e bën. Për shembull, Koalicioni është pjesë e platformës për luftë kundër korrupsionit dhe Rrjeti 23 ku aktivitetet dhe të dhënat nga puna e Koalicionit inkorporohen në përmbledhjet e vëzhgimeve mujore, shpalljet publike, deklaratat dhe planet strategjike dhe politikat me diapazon dhe ndikim më të gjerë gjatë implementimit.

*Dr. Mirjana Ivanova Bojaxhievaska  
Kryetare e koalicionit  
“Të Gjithë për Gjykim të Drejtë”*

## **PËR KOALICION “TË GJITHË PËRGJYKIM TË DREJTË”**

Koalicioni i shoqatave të qytetarëve “Të Gjithë për Gjykim të Drejtë” – Shkup paraqet një organizatë në të cilën marrin pjesë 14 organizata qytetare nga gjithë territori i RM-së edhe atë:

Ambasada e parë për fëmijë në botë Megjashi – Shkup, Asociacioni qytetar MOST – Shkup, Forumi Arsimor Rinor MAR – Shkup, Qendra Kulturore për të Rinjtë QKR – Manastir, Asociacioni për iniciativë demokratike AID – Gostivar, Këshilli për preventivë kundër delikuencës së të miturve KPKDM – Kavadarci, Shoqata për këshillim, shërim, ri-integrim dhe risocializim IZBOR – Strumicë, Shoqata për të drejtat e romëve SHDR – Shtip, Shoqata për të drejtat e fëmijës SHDF – Shkup, Qendra informative qytetare QIQ SPEKTAR – Shtip, Shoqata bamirëse humanitare e romëve SHBHR MESEÇINA – Gostivar, Shoqata e romëve të tikveshit SHRT – Kavadarci, Qendra edukative e romëve QER AMBRELA – Shkup dhe Shoqata qytetare MULTIKULTURA – Tetovë.

### Misioni

Ndjekja dhe respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut, veçanërisht në standardet ndërkombëtare për gjykim të drejtë, përmes formave të ndryshme të veprimit në përpjekje që të rritet niveli i implementimit të tyre, të iniciohen reforma institucionale dhe juridike, si dhe të kthehet besimi i qytetarëve ndaj gjykatës dhe institucionet tjera të sistemit.

### Vizioni

Organizim i fuqishëm dhe stabil, motor dhe partner i institucioneve të sistemit në përpjekjet që Republika e Maqedonisë të ngritet si shtet në të cilin do të respektohen tërësisht liritë dhe të drejtat e njeriut, me një theks të veçantë të standardeve për gjykim të drejtë, si kusht elementar për integrimin në Bashkimin Evropian.

### Qëllimet e koalicionit

- Të rrit respektimin e standardeve për gjykim të drejtë përpara gjykatave të vendit;
- Të ndërtojë besim publik në sistemin juridik dhe gjyqësorin në përgjithësi;
- T'i identifikojë problemet që trashëgohen në sistemin gjyqësor dhe të tregojë nevojën për reformë juridike dhe institucionale;
- Të informojë publikun me standardet për gjykim të drejtë dhe ta forcojë besimin tek qytetarët në funksionimin e sistemit gjyqësor;
- T'i zvogëlojë mundësitë për trajtimin e papërshtatshëm të palëve në mosmarrëveshje nga gjykatësit dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurë.

# 1. LËNDA, QËLLIMET DHE METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

## 1.1. LËNDA E HULUMTIMIT

Korrupsioni është fenomen aktual në nivelin global. Çdo shtet çrrënjosjen e korrupsionit e konsideron si njërin nga prioritetet kryesore dhe merr masa të përshtatshme për preventivë, mbrojtje dhe sanksionim. Korrupsioni në Republikën e Maqedonisë është renditur si problemi i pestë më i madh në shtet (27,9%), pastaj papunësia, varfëria, të ardhurat e ulëta dhe çmimet e larta.<sup>6</sup>

Ekzistojnë më shumë masa të cilat shteti i merr që të merret me këtë problem, ekzistojnë më shumë institucione shtetërore kompetencat e të cilave janë në parandalimin i korrupsionit, zbulimin e hershëm të tij, kontrollin e financave të politikanëve dhe funksionarëve tjerë, edukimin e popullatës dhe inkurajimin e qytetarit që të paraqesë korrupsionin. Megjithatë, pjesë e rëndësishme e obligimit për **t'u marrë me korrupsionin** mbetet sistemi gjyqësor përmes të cilit kryhet sanksionimi i veprave të korruptuara. Më saktë sanksionimi, pikërisht efikasiteti gjyqësor në luftë me krimin e organizuar dhe korrupsionin janë lëndë e kësaj analize.

Në kornizat e PPTH tek ne ekziston Prokurori Publike Themelore e veçantë për hetim të krimit të organizuar dhe korrupsionit. E njëjta ka kompetenca për të vepruar për vepra penale të kryera nga një grup i strukturuar të tre ose më shumë personave, që ekziston një periudhë e caktuar kohore dhe vepron me qëllim që të kryej një ose më shumë vepra penale për të cilat është parashikuar dënim me burg më së paku katër vjet, me qëllim që në mënyrë direkte ose indirekte që të arrihet me përfitim financiar ose me ndonjë përfitim tjetër. Elementi themelor në definimin e krimit të organizuar është që i njëjti të kryhet në grup dhe grupi me vetëdije dhe me qëllim kryen veprime kriminale që të mund përfitojë dobi. Në definimin e krimit të organizuar përfshihen edhe veprat penale të kryera nga një grup i strukturuar ose nga një organizatë kriminale, njëjtë si dhe për veprat penale si shpërdorimi i pozitës zyrtare, vlera e konsiderueshme e ryshfetit, ndërmjetësimi i paligjshëm, prodhimi i paautorizuar dhe, lëshimi në qarkullim i narkotikëve, substancave psikotrope dhe prokursorë, larja e parave dhe të ardhurat tjera me vlerë më të madhe nga veprat penale, kërcënimi terrorist ndaj rendit kushtetues dhe sigurisë, dhënia e ryshfetit në vlerë të konsiderueshme, ndikimi paligjshëm ndaj dëshmitarëve, konspiracioni kriminal, organizata terroriste, terrorizmi, trafikimi i qenieve njerëzore, kontrabandimi i emigrantëve si dhe për veprat tjera penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare nga KP, pavarësisht nga numri shkelësve të ligjit.

---

<sup>6</sup> Nuredinoska, Emina. *“Raporti për vlerësim të korrupsionit në Maqedoni”* [autorë Emina Nuredinoska, Marija Sazdevski, Borjan Gjuzelov] – Shkup: Qendra maqedonase për bashkëpunim ndërkombëtar (QMBN), 2014

Ekzistojnë më shumë forma të krimit të organizuar, varësisht nga ajo se kush e aplikon dhe në cilën lëmi. Në këtë drejtim veprat penale grupohen në forma të organizuara të tregtisë me drogë, forma të organizuara të tregtisë me njerëz, krim i organizuar ekonomik-financiar. Krimi ekonomik-financiar i organizuar drejtpërdrejt është i lidhur me veprimet korruptive, **ndërsa në pajtim me analizën “nevoja për monitorimin e lëndëve gjyqësore nga fusha e korrupsionit”, korrupsioni definohet si shpërdorim i pozitës personale ose të dikujt tjetër ose funksionit me qëllim të profitimit, avantazh dhe përfitim për atë nga të tjerët.**<sup>7</sup>

Gjatë kohëzgjatjes nëntëvjeçare të monitorimit nga ana e Koalicionit të lëndëve nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit, paralelisht është kryer edhe procesi i reformave gjyqësore në Republikën e Maqedonisë. Si rezultat i këtij procesi njëra nga reformat më të mëdha të reformave gjyqësore në legjislacionin maqedonas ka të bëjë me Ligjin e ri për procedurë penale (LPP). Domethënë se, ligjin e ri për procedurë penale janë sjellë shumë ndryshime të cilat do të rishqyrtohen më tej në mënyrë individuale. Si ndryshim më i madh dhe kyç është lënia e modelit inkuizitor dhe aplikimi i modelit akuzues. Gjatë viteve 2015 dhe 2016 gjithashtu ndodhën dhe ndryshimet tjera ligjore dhe politike në vend. Gjegjësisht, për shkak të krizës<sup>8</sup> politike në vend u shpreh nevoja për krijimin e Prokurorisë Speciale Publike (PSP) e cila është përgjegjëse për hetimin dhe ndjekjen e veprave penale që kanë të bëjnë dhe që dalin nga përmbajtja e përgjimit të paligjshëm të komunikimeve, me qëllim të zbatimit të drejtësisë përmes principit të sundimit të ligjit.<sup>9</sup> Në thelbin e punës së PSP janë pikërisht lëndët nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Gjithashtu si rezultat i krizës politike, përkatësisht zgjidhja e saj, në pajtueshmëri me Raportin e Pribes gjatë vitit 2015 është punuar në miratimin e një **ligji të ri për të ashtuquajturit “informues” (“whistle-blowers”) i cili hyri në fuqi më 18.03.2016** i quajtur si Ligji për mbrojtjen e atyre që tregojnë.<sup>10</sup> Përveç kësaj, më 12 prill të vitit 2016 Presidenti i shtetit morri vendim që të nënshkruaj abolicion për të gjithë politikanët kundër të cilëve është ngritur padi, të cilët janë nën hetime ose të cilët janë duke vuajtur burg. Për shkak të kësaj një pjesë të procedurave që i kemi monitoruar u ndërpreu, dhe të njëjtat vazhduan pas tërheqjes së abolicionit nga ana e Presidentit të shtetit.<sup>11</sup>

Nevoja për të monitoruar lëndët nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit ishte aktuale gjatë viteve të mëparshme, sidomos këtë vit kur realiteti për partizimin e gjyqësorit në Republikën e Maqedonisë, për mosrespektimin e principit të sundimit të ligjit

---

<sup>7</sup> Analizë për Nevojë e ndjekjes së lëndëve gjyqësore nga lëmia e korrupsionit, prof. dr. Ljupço Arnaudovski, doc. Dr. Slagjana Taseva, Suzana Saliu, Koalicioni Të gjithë për gjykim të drejtë, Shkup viti 2007.

<sup>8</sup> Kronologji e krizës politike në Maqedoni

<sup>9</sup> Progress Report Macedonia 2015,

[www.wbcrti.info/object/document/14557/attach/20151110\\_report\\_the\\_former\\_yugoslav\\_republic\\_of\\_macedonia.pdf](http://www.wbcrti.info/object/document/14557/attach/20151110_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf)

<sup>10</sup> Ibid

<sup>11</sup> Më 27.05.2016, Presidenti i Republikës së Maqedonisë Gjorge Ivanov tërhoqi vendimet për abolimin e 22 **personave ose “persona të ekspozuar politik”** – kryerës të dyshimtë të veprave penale, për të cilët janë ngritur padi penale dha kanë nisur procedura penale, shumica prej tyre të inicuar nga Prokuroria Speciale Publike.

dhe mungesa e ndarjes së pushteteve u vërtetua edhe në regjistrimet e bisedave të funksionarëve të lartë shtetëror që u bënë publike. Sipas këtyre regjistrimeve shërbime shtetërore në mënyrë të paligjshme kanë ndjekur komunikimin e më shumë se 20.000 qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, si dhe një pjesë e funksionarëve në qeveri dhe persona të afërt me to kanë bërë një numër të madh të veprave penale duke filluar nga rrezikimi i sigurisë e deri tek shpërdorimi i detyrës zyrtare, shoqërim kriminal dhe mashtrim zgjedhor në përmasa të mëdha. Nga bisedat e publikuara një pjesë ka të bëjë edhe me gjyqësorin dhe mënyrën se si ekzekutivi ka ndikuar në zgjedhjen e gjykatësve dhe prokurorëve publik, por edhe ajo se si negociojnë për vendimet për raste të caktuara gjyqësore. Bisedat e publikuar në vazhdim japin indikacione për lidhjen e ekzekutivit me prokurorin e përgjithshëm publik të Republikës së Maqedonisë.<sup>12</sup>

Pikërisht për shkak të asaj që përmend më lartë sytë e publikut janë drejtuar në përfundimet gjyqësore ose në fillimet gjyqësore të veprimeve kriminale korruptive të përfshira në bisedat e përgjuara. Procesi i monitorimit është kryer në mënyrë që theksi ishte vendosur në mënyrën e zbatimit të procedurës penale, gjegjësisht në kohëzgjatjen e vet procedurës penale, arsyet për anulim të së njëjtës, të drejtën për mbrojtje gjatë procedurës penale dhe parametrat tjerë që e përcaktojnë efikasitetin gjyqësor në luftë me krimin e organizuar dhe korrupsionin, zbatimi i standardeve për gjykim të drejtë dhe zbatimi i dispozitave të reja nga LPP.

## 1.2. QËLLIMET E HULUMTIMIT

Objektivi kryesor i projektit, por edhe i vet analizës është për të përforcuar pavarësinë, efikasitetin dhe paanshmërinë e gjyqësorit maqedonas në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe për të kontribuar drejt implementimit të duhur të reformave penale-juridike me fokus kryesor në Ligjin e ri për procedurë penale.

Të monitoruara ishin lëndët përpara departamentit për krim të organizuar dhe korrupsion, lëndë tjera korruptive dhe lëndë me rëndësi për publikun.

Në lëndët e monitoruara ishin përfshirë veprat penale si prodhimi i paautorizuar dhe shitja e drogave, substancat psikotrope dhe prokursorët, mashtrimi, grabitja, kamata, fshehje, larja e parave dhe të ardhurave tjera nga krimi, kontrabanda, shpërdorimi i pozitës zyrtare dhe autoritetit, marrja e ryshfetit, dhënia e ryshfetit, falsifikimi i dokumentit zyrtar, ndikimi i paligjshëm ndaj dëshmitarëve, falsifikimi i dokumentave, shoqërimi kriminal, organizata terroriste, rrezikimi terrorist i rendit kushtetues dhe sigurisë, terrorizmi, falsifikimi ose shkatërrimi i librave afarist, vrasja, falsifikimi i të parave, evazioni fiskal, kontrabanda, trafikimi me qenie njerëzore, kontrabandimi i emigrantëve, organizimi i një grupi dhe nxitja për të kryer veprat si trafikimi i njerëzve, trafikimi me persona të mitur dhe kontrabandimi i emigrantëve, trafikimi i fëmijëve, keqpërdorimi i regjimit pa viza me shtetet

---

<sup>12</sup> Çalovska, Neda, mr. Golubovska, Jasmina, mr. Stojanovski, Vojislav, dhe mr. Jovanoski Aleksandar, "Gjyqësori dhe të drejtat themelore në Republikën e Maqedonisë", viti 2015.

anëtarë të Unionit Evropian dhe të marrëveshjes së Shengenit, pjesëmarrja në turmë që do ta parandalojë personin zyrtar që të kryej detyrat zyrtare, dhuna ndaj përfaqësuesve të organeve më të larta shtetërore dhe spiunimi.

Ndjekja e problemeve me korrupsioni dhe krimin e organizuar, por edhe nevoja për sigurinë e pavarësisë gjyqësore janë potencuar në raportet e GREKO, raportet për përparimin e Republikës së Maqedonisë si dhe në prioritetet urgjente reformuese të grupit të ekspertëve në krye me Pribe. Në raportin për përparimin e Republikës së Maqedonisë për vitin 2016 është caktuar se për realizimin e prioriteteve urgjente reformuese është vërejtur një përparim i kufizuar, por është vërtetuar regres në dy vite radhazi në fushën kyçe të gjyqësorit. Sa i përket korrupsionit, në lidhje të ngushtë me gjyqësorin shihet se Republika e Maqedonisë më shumë se 10 vite i është dedikuar reformave në këto fusha, por se ndikimi politik serioziteti i fundos arritetet e mëparshme.<sup>13</sup> Megjithatë, përveç se teorikisht, nuk është bërë asnjë progres tjetër në vitin e fundit të në problemet e identifikuar dhe korrupsionin, po, përkundrazi drejtpërdrejtë është vërejtur se Republika e Maqedonisë është “shtet i skllavëruar” në institucionet, duke përfshirë edhe gjyqësorin dhe mediat.<sup>14</sup>

### 1.3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Qëllimi kryesor i hulumtimit është që përmes të dhënave të marra nga lëndët vëzhguara të ndikohet në përforcimit e pavarësisë, efikasitetit dhe drejtësisë në gjyqësi në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe të jepet kontribut në implementimin e përshtatshëm të reformave gjyqësore, në pajtim me dokumentet strategjike të RM për integrim në BE. Që do të thotë, duke filluar nga pasojat e dëmshme të korrupsionit dhe krimit të organizuar hulumtimi duhet të jep pasqyrën për rrjedhën e procedurave për këtë lloj të veprave penale, ose të jep analizë të detajuar për fazat në procedurë përmes së cilës do të përcaktohet efikasiteti i gjyqësisë me legjislacionin e ri për procedurë penale, do të vlerësohet niveli i respektimit të drejtë dhe gjykim i drejtë, dhe në këtë mënyrë do të rrite besimi i qytetarëve në sistemin gjyqësor. Në këtë drejtim njëra nga objektivat e hulumtimit ishte edhe implementimi i ligjeve të reja në LPP në drejtim të efikasitetit të rritur, por edhe mbrojtjen e të drejtave të personave të akuzuar.

Metodat të cilat i përdor Koalicioni janë: vëzhgimi dhe instrumenti – pyetësor i cili për nevojat e Koalicionit është përpunuar nga ekspertët të fushës dhe që çdo vit gjatë ripërdorimit përmirësohet. Vëzhgimi si metodë mundëson shënim direkt nga ana e vëzhguesit, gjegjësisht shënim të drejtpërdrejtë të lëndës së hulumtimit. Në këtë drejtim lëndët e identifikuar të cila cilat kanë të bëjnë me krimin e organizuar dhe korrupsion përpara departamentit për krim të organizuar dhe korrupsion të cilat janë sipas Ligjit të ri

---

<sup>13</sup> Commission Staff Working Document

The former Yugoslav Republic of Macedonia 2016 Report

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2016/20161109\\_report\\_the\\_former\\_yugoslav\\_republic\\_of\\_macedonia.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2016/20161109_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf)

<sup>14</sup> Ibid.



për Prokurori Publike ishin të vëzhguar nga ana e 4 vëzhguesve, edhe atë nga një ekip prej dy vëzhguesish më me përvojë dhe 2 avokat/e të theksuar/a në atë fushë. Në këtë mënyrë vëzhgimi ishte përforcuar me perceptimin dhe aftësitë e vëzhguesve më të theksuar të koalicionit dhe avokat/e të cilët kanë monitoruar direkt lëndët gjyqësore.

Metoda e dytë e plotësimit të pyetësorit ishte formë e përgatitur paraprakisht e 74 pyetjeve të cilat së bashku me përgjigjet ishin dorëzuar deri tek koordinatorja e projektit dhe ishin futur në bazën e të dhënave të koalicionit. Ky aktivitet ishte i rëndësishëm për shkak të faktit se të dhënat të cilat merren nga ana e vëzhguesve/eve janë të dhëna të cilat japin një pasqyrë të paanshme dhe transparente për rastin që vëzhgohet. Me analizën s pyetësorëve dhe me përpunimin e tyre të vonshëm dhe prezantimin e rezultateve të hulumtimit në publikimin përfundimtar, raporti merr një vlerë të re, të mbështetur me të dhëna të reja dhe relevante për situatën me lëndët gjyqësore nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Pyetësorët janë plotësuar drejtpërdrejt gjatë kohës së pranisë së procedurave gjyqësore, ndërsa në këtë pjesë për të shënuar është fakti se në pjesën tekstuale të përgjigjeve të pyetjeve kishte vërejtje nga ana e vëzhguesve/eve të cilët grupi punues për përpunimin e pyetësorit nuk i ka marrë parasysh dhe/ose vërejtjet të cilat mund të jenë thjeshtë deskriptive. Pra, zakonisht gjatë përpunimit të pyetësorëve në data bazë futet vetëm vepra e parë penale, që çon drejt përfundimit të gabuar për llojet e veprave penale, pasi që në veprat të cilat janë nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit më shpesh bëhet fjalë për më shumë vepra penale. Kjo mangësi ishte zbuluar në kohë, gjatë së cilës një numër i madh i të dhënave që janë elaboruar në këtë analizë janë si rezultat jo vetëm i të dhënave të përpunuara statistikore, por edhe si rezultat i përpunimit manual të pyetësorëve. E njëjta metodë përdoret edhe në pjesën përpunimi i pyetjeve tekstuale, të cilat vëzhguesve u mundësojnë të vërejnë drejtpërdrejtë narrativet e specifikave të caktuara gjatë procedurës.

Përveç kësaj, mungesa e disa përgjigjeve është rezultat i kycjes në fazat e mëvonshme të procedurës, por edhe periudha e shkurtër kohore e vëzhguesve me të cilën nuk mund të mbulohet as edhe rezultati përfundimtar i lëndëve, respektivisht për të pasur informacion për vendimet e marra gjyqësore, si dhe politika penale për vepra penale nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsioni. Përpiqemi që vetëm një pjesë e vogël e **vëzhgimeve t'u referohen lëndëve që janë ngritur më parë, që të mund të bëjmë një analizë e cila jep do të jep përgjigje për gjithë procesin gjyqësor, që nga fillimi i procedurës e deri tek marrja e vendimit gjyqësor.**

## 2. ANALIZA E REZULTATEVE NGA VËZHGIMI I LËNDËVE NGA FUSHA KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT

### 2.1. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Të dhënat e analizave janë për periudhë 9 mujore, për të cilën periudhë kohore ishin vëzhguar 75 lëndë me 224 seanca, në Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup. Ideja fillestare e projektit ishte që të vëzhgohen lëndë në departamentin për krim të organizuar dhe korrupsion, lëndë tjera korruptive si dhe lëndë të cilat janë me rëndësi për publikun në pajtim me situatat aktuale në vend.

Sipas bazës së të dhënave janë monitoruar 37 lëndë në departamentin për krim të organizuar dhe korrupsion, 4 lëndë me rëndësi për publikun dhe të cilat kanë të bëjnë me protestat e 5 majit të vitit 2015 dhe të 12 prillit të vitit 2016, si dhe mostër prej 34 lëndëve korruptive.

*Përfundim: nga të dhënat përgjithshme në departamentin për krim të organizuar dhe korrupsion mund përcaktohet se numri më i madh i veprave penale kanë të bëjnë me vepra nga fusha e trafikimit të qenieve njerëzore, kontrabandimi i emigrantëve dhe organizimi i një grupi dhe nxitja për kryerje të veprave trafikim të personave të mitur (neni 418-**a**, **418-b**, **418-e**, **418-z**, 418-**d** nga KP), respektivisht kjo vepër penale në mënyrë të pavarur ose në korrelacion me veprat tjera penale paraqitet në 12 raste. E dyta, vepër penale e cila më shpesh paraqitet është prodhimi i paautorizuar dhe futja në treg e drogave narkotike dhe prokursorë të tjerë dhe shpërdorimi i pozitës zyrtare dhe autoritetit. Veprat tjera penale janë shoqërimi kriminal, falsifikimi i parave, marrja e ryshfetit dhe falsifikimi i dokumenteve.*


Nga veprat tjera kriminale, pjesa më e madhe kanë të bëjnë me veprën penale mashtrim, madje edhe në 20 raste, pastaj prodhimi i paautorizuar dhe futja në treg e drogave narkotike dhe prokursorët tjerë dhe fshehja, ndërsa në numër më të vogël janë veprat falsifikimi ose shkatërrimi i librave afarist, shpërdorimi i pozitës zyrtare dhe autoritetit, falsifikimi i dokumenteve, evazioni fiskal dhe falsifikimi i dokumenteve zyrtare.

Nga veprat që janë me rëndësi për publikun ishin të vëzhguar **“Lagjja e Trimave”**, **“Puçi”**, **“Rover”** dhe lëndët që dolën nga protestat e majit të vitit 2015 dhe prillit të vitit 2016.

*Përfundim: numri i përgjithshëm i të pandehurve në 70 rastet e montuara është 168, ndërsa për 5 lëndë kjo e dhënë nuk është marrë.*

Fokusi i monitorimit këtë herë është vendosur në krimin e organizuar dhe korrupsionin nga njëra anë dhe implementimin e ligjit të ri për prokurori publike nga ana

tjetër. Lidhja e ngushtë mes veprave penale nga fusha e krimit të organizuar dhe veprave penale korruptive më konkretisht e pasqyron situatën në të cilën ndodhet një shoqëri si dhe mekanizmat gjyqësor të cilët janë përgjigje e asaj situatë. Më tej, reforma gjyqësore për LPP gjithashtu tregon përpjekjet legjislative për shuarjen më të mirë dhe më efektive të krimit.



Vepra penale

Është vënë re se këtë vit njëjtë si vitin e kaluar<sup>15</sup> numri më i madh i veprave penale nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit kanë të bëjnë me kontrabandim të emigrantëve dhe tregti me njerëz. Rritja e këtyre veprave penale gjatë vitit 2015 dhe 2016 përballë përfaqësimit të tyre më të vogël në vitet e kaluara, sjell deri në përfundim se kriza e refugjatëve dhe emigrantëve drejtpërdrejt e shqetëson Republikën e Maqedonisë e cila është destinacion kryesor transit i refugjatëve dhe emigrantëve, dhe shfrytëzohet nga ana e grupeve kriminale. Nga ana tjetër, shteti është i detyruar të sigurojë kushte për transitin e sigurt të këtyre personave, në vend që të injorojë këtë situatë në krahasim me ndjekjen penale të njerëzve të cilët bëjnë transport jo legal të të njëjtëve. Me ndryshimet e Ligjit për Azilin dhe mbrojtjes së përkohshme qëllimi i së cilës është të kapërcehet, pikërisht të parandalohet problemi i emigracionit ilegal, ndërsa nga ana tjetër të lehtësohet azilkërkuesit potencial e drejta për azil aksesit deri tek organi i cili zhvillon procedurën për njohje të së drejtës për azil, pjesërisht shteti mori masa për rregullimin e këtij fenomeni, por me sa duket është e nevojshme një periudhë **e gjatë kohore që ky rregullim t'i** tregojë pasojat juridike përmes zvogëlimit të numrit të këtyre procedurave gjyqësore.<sup>16</sup>


Standardet ndërkombëtare në të njëjtën kohë përcaktojnë ndalim të ngacmimit dhe frikësimit të avokatit, të drejtën për komunikim të sigurt me avokatin, si dhe të drejtën për ndihmë juridike pa pagesë. Njëra nga të drejtat themelore të të akuzuarit është e drejta për avokat. LPP përcakton edhe ekzistimin e një avokati të detyrueshëm dhe avokat me detyrë zyrtare. Në qoftë se i akuzuari është shurdhmemec ose i paaftë që të mbrohet vet me sukses, ose në qoftë se kundër tij kryhet procedurë penale për vepër penale për të cilën ligji parashikon dënim me burg të përjetshëm, duhet të ketë avokat që nga seanca e parë gjyqësore. I akuzuari duhet të ketë mbrojtës në qoftë se kundër tij është caktuar masë paraburgim deri sa zgjat paraburgimi. Kur nuk ekzistojnë kushte për mbrojtje të detyrueshme, në qoftë nuk është në gjendje të paguaj shpenzimet e mbrojtjes, të **akuzuarit mund që sipas kërkesës së tij t'i caktohet avokat, kur këtë e** kërkon interesi i drejtësisë, ndërsa veçanërisht peshja e veprës penale dhe ndërlikueshmëria e rastit.

*Përfundim: Të dhënat nga vëzhgimet tregojnë se në 87% të rasteve të akuzuarit kanë pasur avokatin e vet, prej të cilëve 7% avokati ka qenë sipas detyrës zyrtare, ndërsa në 13% të rasteve të akuzuarit nuk kanë pasur avokat.*

Lidhur me këtë të dhënë, kur personat e akuzuar nuk kanë pasur avokat më shpesh bëhej fjalë për procedurë për vepër penale për të cilat mbrojtja nuk ka qenë e detyruar ose të njëjtat janë shtyrë për shkak të përcaktimit të avokatit sipas detyrës zyrtare.

<sup>15</sup> Aleksandra Bogdanovska, "Efikasiteti gjyqësor në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit" – Koalicioni Të gjithë për gjykim të drejtë, viti 2015 [http://all4fairtrials.org.mk/wp-content/uploads/2016/06/INL\\_Analiza\\_2015\\_MKD.pdf](http://all4fairtrials.org.mk/wp-content/uploads/2016/06/INL_Analiza_2015_MKD.pdf)

<sup>16</sup> Ligji për azil dhe mbrojtja e përkohshme, <http://www.pravdiko.mk/zakon-za-azil-i-privremena-zashtita>




*Mbrotësi i të akuzuarit*

### 2.1.1. Aplikimi i procedurës së shkurtuar

Procedura e shkurtuar kryhet për veprat penale për të cilat si dënim kryesor kanë paraparë gjobë monetare ose burgim deri në 5 vjet, dhe e njëjta është iniciuar me propozim akuzues ose padi private

*Përfundim: Sipas të dhënave të përpunuara procedurë e shkurtër është kryer në 29% të rasteve, pikërisht 22 lëndë, 44 lëndë (59%) janë kryer procedurë të rregullt dhe për të tjerat 12%, pikërisht për 9 lëndë kjo e dhënë është e panjohur.*



*Procedurës së shkurtuar*

### 2.1.2. Gjykimi publik

Gjykimi publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme paraqet një pjesë të standardeve për gjykim fer dhe të drejtë. Neni 6 i Konventës evropiane për të drejtat dhe liritë e njeriut (KEDNJ)<sup>17</sup> i garanton çdokujt se gjatë kohës së përcaktimit të të drejtave dhe të detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze

<sup>17</sup> Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ([http://www.echr.coe.int/Documents/Convention\\_MKD.pdf](http://www.echr.coe.int/Documents/Convention_MKD.pdf)), Këshilli I Evropës, viti 1950;

penale kundër tij ka të drejtë për gjykim publik. Kjo dispozitë kërkon praninë e të dy palëve në gjykim, si dhe dëgjimi të jetë i hapur për publikun.

Gjykimi publik është i rëndësishëm pasi që në atë mënyrë garantohet edhe besimi në gjykatën, si dhe parandalimi i shtypjeve eventuale ose ndikimi gjatë kohës së procedurës gjyqësore. Çështja e drejtësisë në gjykimin publik është vërtetuar edhe në Deklaratën universale për të drejtat e njeriut,<sup>18</sup> si dhe në Paktin ndërkombëtar për të drejtat politike dhe qytetare.<sup>19</sup> Dëgjimi publik në fakt paraqet seancë gojore mbi thelbin e mosmarrëveshjes në praninë e publikut, duke përfshirë edhe mediat.<sup>20</sup> Gjykimi publik gjithashtu është princip i referuar si në Kushtetutën e R.M.<sup>21</sup> ashtu edhe ligjet procedurale.<sup>22</sup>

*Përfundim: në qoftë se shihen të dhënat nga vëzhgimi mund të shihet se 96% e seancave kanë qenë publike, ndërsa në 4% të seancave prania e publikut ka qenë e ndaluar në përshtatshmëri me dispozitat ligjore.*

Prania e mediave gjithashtu ka qenë gjithmonë e lejuar kur ka qenë e lejuar edhe prania e publikut në gjykim. Publicitet më të madh tërheqën lëndët me rëndësi për publikun siç janë “Lagja e Trimave”, “Puçi”, gjykimet për demonstrantët dhe “Rover”. Gjatë mbajtjes së këtyre seancave siguria e gjyqit, si dhe procedura për paraqitjen e personave që duan të jenë prezent, si dhe mos gjetja e vendit përkatës për lëndën “Lagjja e Trimave” e vështirësuan këtë proces për njoftimin në kohë të kohës dhe vendit dhe mundësisë për prani në këto gjykime. Ndërsa përsëri, sa i përket caktimit të kohës dhe vendit të gjykimeve të cilat janë të nevojshme të jenë publikisht të publikuara në tabelën jashtë sallës së gjyqit është vërejtur nga ana e vëzhguesve se në 20% të raste e njëjta gjë nuk është bërë. Mundësia për kontrollë të procedurave gjyqësore në ueb faqen e gjyqit është shfrytëzuar rregullisht si mjet nga ana e vëzhguesve/eve, por shpesh vjen deri tek mospajtimi i të dhënave të publikuara për kohën dhe vendin për mbajtjen faktike të seancave gjyqësore në kohën dhe vendin e dhënë.

<sup>18</sup> Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Kombet e Bashkuara, viti 1948.


<sup>19</sup> Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, viti 1996.

<sup>20</sup> Gjykim i drejtë, Doracak/ Fair Trials Manual, Fondi për të Drejtën Humanitare Beograd 2001 (përkthim i Amnesty International Fair Trials Manual)

<sup>21</sup> Kushtetuta e R.M., Gazeta Zyrtare nr. 52, 22.11.1991

<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/19D704B29EC040A1968D7996AA0F1A56.pdf>

<sup>22</sup> Ligji për Procedurë Penale, Gazeta Zyrtare R.M., nr. 150 nga 18.11.2010



*Gjykimi publik*

### 2.1.3. Përgatitja dhe kushtet për mbajtjen e seancës kryesore

Seanca kryesore në procedurën penale është faza qendrore e të njëjtës. Pavarësisht miratimit të të ashtuquajturit Ligj të ri për procedurë penale kanë kaluar 6 vjet, dhe 3 vjet nga zbatimi i tij, megjithatë, ende mbizotërojnë konkluzionet që kanë të bëjnë me tranzicionin e ngadalshëm të ligjit të vjetër për PP. Seanca kryesore në vete e përfshin procedurën dëshmuese dhe paraqitjen e provave. Me LPP janë rregulluar rolet e të gjithë pjesëmarrësve në procedurë edhe atë në mënyrën në të cilën Gjykata është vendosur në rolin pasiv, ndërsa palët në procedurë / prokurorët dhe avokatët janë ata të cilët kanë rolin kryesor gjatë sigurimit, propozimit dhe paraqitjes së provave, ndërsa me këtë edhe përgjegjësia më e madhe bie mbi palët në procedurë.

Që të mund të vlerësojmë seancën kryesore parasëgjithash e nevojshme është që të trajtojmë kushtet e mbajtjes së saj. Në krahasim me vitin e kaluar kemi rritje të mosrespektimit të kohës dhe vendit të mbajtjes së seancave. Një arsye shtesë për pasojat e tilla është edhe greva e administratës gjyqësore e cila zgjati nga 18.05.2016 e deri në fillim të muajit shtator<sup>23</sup> si dhe **lënda “Lagja e Trimave”**. **Lënda “Lagja e Trimave” e cila është me rëndësi të madhe për gjithë publikun dhe që mbahet (16 seanca në periudhë prej shkurtit e deri në mesin e tetorit të vitit 2016) me siguri të madhe policore dhe për shkak të së njëjtë lëndët tjera të caktuara në të njëjtën ditë gjithmonë anulohen dhe/ose vëzhguesve nuk u lejohet hyrja në Gjykatë.**

<sup>23</sup> Greva e administratës gjyqësore,  
[http://zsarm.com/read\\_more.php?un=151304dfdab76e1463da824883c7c079b4e3b2e1](http://zsarm.com/read_more.php?un=151304dfdab76e1463da824883c7c079b4e3b2e1)

*Përfundim: në bazë të të dhënave të marra nga ana e vëzhguesve mund të konkludojmë se përgatitjet për seancën kryesore, do me thënë caktimi i seancës kryesore në kohë dhe vend të caktuar në Gjykatë është se Gjykata shpesh nuk e respekton kohën e fillimit të seancës, por shpesh edhe ndryshimin e vendit për mbajtjen e të njëjtës.*

Për dallim nga viti i kaluar kur në mënyrë të përsëritur është vënë në dukje se seanca të caktuara aspak nuk mbahen dhe për to nuk ekziston as shpjegim e as termin të parashikuar të radhës, gjatë këtij viti ky fenomen është vërejtur shumë shpesh. Gjegjesisht, gjatë muajit janar dhe shkurt të vitit 2016 në Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup kanë ndodhur ndryshime brenda kuadrit ku u bë ndërrimi i gjykatësve nga njëri vend në tjetrin vend të punës që drejtpërdrejtë ndikoi në sasinë dhe cilësinë e procedurave në këtë periudhë kohore.<sup>24</sup> Në momentin kur ndryshim filloi funksionojë ashtu **siç duhet, filloi lënda “Lagja e Trimave” e cila siç është shpjeguar më lartë përsëri ndikoi** në rrjedhën e procedurave gjyqësore. Gjatë kohës së pushimeve në Gjykatë e cila zgjat nga 15 korriku e deri më 15 gusht erdhi deri tek reduktimi i procedurave gjyqësore si dhe deri tek rritja e numrit të lëndëve të anuluar. Së fundi, në fillim të shtatorit situata e pasigurt rreth zgjatjes, gjegjesisht vazhdimit të grevës së administratës gjyqësore çoi deri tek një valë e lëndëve të anuluar.


Lëshimet e tilla e vështirësojnë si punën e vëzhguesve/eve ashtu edhe të publikut i cili ka të drejtë ligjore të merr pjesë në gjykim. Anulimi i seancave pa shpjegim dhe mos mbajtja e tyre është në kundërshtim me parimin e transparencës dhe paanshmërisë së Gjykatës. Por edhe, rezistenca e madhe e gjykatësve ndaj publikut dhe qëndrimit mbrojtës të gjyqësisë në tërësi, drejtpërdrejtë reflektohet edhe në pjesën tjetër të administratës gjyqësore, veçanërisht nga ana e policisë gjyqësore. Disa anëtarë të policisë gjyqësore **shpesh sillen ashpër me vëzhguesit, edhe pse Koalicioni “Të gjithë për gjykim të drejtë”** më shumë se 13 vjet bashkëpunon mirë me Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup. Kjo sjellje e policisë gjyqësore është e palejueshme pasi që vetëm Gjykata ka të drejtën e vetme që me ligj të caktojë raste ligjore për të përjashtuar publikun nga seanca kryesore.

*Përfundim: Nga 75 lëndët e monitoruara me numër total 224 seanca, vetëm 66 kanë pasur veprime në procedurë, ndërsa 158 seanca janë anuluar.*

Kjo e dhënë është befasuese, 70% të seancave janë anuluar për shkaqe të cilat më hollësisht do të shpjegohen më tej. Shumë shpesh gjatë periudhës së monitorimit nga muaji janar duke përfshirë edhe muajin shtator ka një numër të madh të lëndëve që janë **monitoruar të cila gjatë gjithë kohës janë anuluar, shembull për këtë është lënda “Rover”** e cila ka pasur 9 seanca dhe të gjitha janë anuluar.

<sup>24</sup> Ndryshimet e personelit të Gjykatës Penale - Shkup, <http://www.akademik.mk/kadrovski-promeni-vo-skopskiot-krivichen-sud/>






### Veprimet procedurale

Karakteristika themelore e seancës kryesore në pajtueshmëri me Ligjin e ri për PP është akuzat, ku palët propozojnë dhe prezantojnë provat gjatë së cilës Gjykata është e liruar nga propozimi i provave me vet iniciativë. Barrën për të treguar provat në seancën kryesore e kanë palët gjatë ku prokuroria ka për obligim të dëshmojë fajin e personit të akuzuar. Megjithatë, Gjykata mban rolin kontrolluesi cili është i nevojshëm për zhvillimin e pandërprerë të gjyqimit. Që të mund të mbahet seanca kryesore e nevojshme është që të sigurohen kushte të përshtatshme, ndërsa me rëndësi është veçanërisht prania e të gjithë personave të ftuar.

*Përfundim: Nga të dhënat e marra nga lëndët e vëzhguara mund të vërejmë se vetëm në 26% të seancave kanë qenë të pranishëm të gjithë personat e ftuar, gjegjësisht në 73 seanca. Në pjesën tjetër më së shumti ka munguar personi i akuzuar në 83 seanca ose 30% të rasteve. Prokurori publik ka munguar në 45 seanca ose 16% të rasteve. Mungesa e avokatit mbrojtës është vërejtur në 23 raste, gjegjësisht 8% të rasteve. Këtë vit si përgjigje e veçantë shtesë e kësaj çështjeje ishte edhe përfaqësimi jo i plotë i këshillit gjyqësor. Kjo nevojë u fut për shkak të paraqitjes më të shpeshtë të kësaj arsyeje gjatë monitorimit vitin e kaluar. Është vërejtur se përfaqësimi jo i plotë i këshillit gjyqësor si shkak për anulimin e seancave është paraqitur në 11 seanca. (27 seanca). Në 45 seanca është vërejtur se të njëjtat janë anuluar për shkaqe të tjera, këtu më shpesh janë arsyet si anulimi i seancës pa mbajtjen e seancës dëgjuese, mungesa e çdo informate para hyrjes në Gjykatë si dhe anulimi i të gjitha lëndëve penale për shkak të lëndës **“Lagjja e trimave.”***



*Prania në seancën kryesore*


Për shkak se të dhënat për numrin e masave të vendosura për siguri më shpesh mungojnë, vështirë të vërtetohen arsyet e mos pranisë së personit të akuzuar, gjegjësisht se a kanë ekzistuar shkaqe objektive të cilat varen nga organet të cilat i zbatojnë masat për siguri. Megjithatë, gjatë analizës cilësore të pyetësorëve, arsyeja më e shpeshtë për mos praninë e personit të akuzuar është ajo se nuk janë zbatuar në seancën për dëgjim masa për burgim ose paraburgim.

Ky problemi paraqitet në çdo analizë dhe raport të Koalicionit, por i njëjti as që është temë diskutimi, bile edhe assesit të zgjidhet. Gjithashtu në një numër të caktuar të lëndëve, gjegjësisht seancave është vërejtur se i akuzuari të akuzuarit janë të paarritshëm për organet e hetimit, do të thotë se janë arrati. LPP parasheh që i akuzuari të gjykohej në mungesë vetëm në qoftë se është në arrati ose në qoftë se është i paarritshëm për organet shtetërore, dhe në të njëjtën kohë ekzistojnë arsye të rëndësishme që të gjykohej në mungesë, të cilën dispozitë ligjore Gjykata e përdor kur ekzistojnë kushte ligjore. **Për t'u shqetësuar është fakti kur deri te anulimi i seancave vjen si rezultat i mos pranisë së PPK.** Në 16% nga seancat e monitoruara mos prania e PPK është shkaktar për anulimin e seancës. Mos prania e PPK ka qenë më shpesh si rezultat i përfshirjes së tij në ndonjë lëndë tjetër me rëndësi më të madhe, është i zënë në ndonjë lëndë tjetër paraburgimi, udhëtim zyrtar dhe për shkaqe shëndetësore. Por, shqetësues është fakti se në bazë të të dhënave shpesh mos prania e PPK është pa arsyetim, ndërsa Gjykatë këtë gjë e toleron, duke mos e zbatuar nenin 364 të LPP. Kjo e dhënë tregon faktin se prokuroria publike nuk disponon me numër të mjaftueshëm prokurorëve publik dhe/ose me plan pune të pa sinkronizuar kohor midis Gjykatës dhe PPK, si dhe organizim i papërshtatshëm në PPK.

*Përfundim: Mos prania e dëshmitarëve dhe ekspertëve është vërejtur në 53% të seancave ku prania e tyre ka qenë me rëndësi për mbajtjen e seancës dëgjuese.*

Gjykata është e obliguar t'i njoftojë dëshmitarët dhe ekspertët në rast të mos mungesës së paarsyeshme të njëjtit mund të sillen me forcë deri në Gjykatë, ose të gjobohen derisa ekziston ftesë e rregullt, ndërsa nëse mungesa nuk arsyetohet. Gjithsesi

të dhënat e vëzhgimit përsëri e nxjerrin në pah si problem mungesën e cila mund të jetë pasojë për shkak të dorëzimit të parregullt, por edhe për shkak të përgjegjësive së pamjaftueshme tek qytetarët për nevojën e pranisë në seancën kryesore



*Prania e të gjithë dëshmitarëve dhe ekspertëve*


#### 2.1.4. Fjalimi hyrës

Me Ligjin e ri për PP seanca kryesore fillon me mbajtjen e fjalimeve hyrëse. Së pari flet prokurori, pastaj avokati mbrojtës ose i akuzuari, prokurori ka të drejtë të mos mbajë fjalim hyrës. Në fjalimet e tyre palët mund të paraqesin faktet përfundimtare që synojnë t'i dëshmojnë, të shfaqin **provat që do t'i zhvillojnë, të caktojnë çështjet juridike që do t'i diskutojnë. Në fjalimet hyrëse nuk duhet të paraqiten fakte** për dënimet e mëparshme të të akuzuarit.<sup>25</sup>

*Përfundim: Sipas të dhënave të marra nga lëndët e monitoruara, kjo risi me sukses zbatohet, dhe në atë drejtim në 17 lëndë të cilat ishin monitoruar që nga fillimi, në të gjitha ishin mbajtur fjalimet hyrëse, në 16 lëndë prokurori publik mbajti fjalimin e tij hyrës, në 11 lëndë avokati mbrojtës dhe në 4 lëndë prokurori. Në 1 lëndë është vërejtur se gjykatësi nuk ka lejuar që i akuzuari të mbajë fjalim hyrës.*

Në 58 lëndët e mbetura mungon kjo informatë që shoqëron përfshirjen me vonës të vëzhguesve në procedurë, gjegjësisht monitorim të lëndës në fazë të mëvonshme, pra në 22 raste të cilat janë zhvilluar me procedurë të shkurtër fjalimet hyrëse nuk janë të detyrueshme, ndërsa gjithashtu 39 lëndë të monitoruara për kohëzgjatjen e periudhës së monitorimit gjatë gjithë kohës kanë qenë të anuluar.

<sup>25</sup> Shopova Ivanonovska, Ljiljana, Gjykatës në Gjykatën e Apelit Shkup, Dimitrievski, Zoran Gjykatës në Gjykatën e Apelit Shkup, Mariçiq Momir, anëtarë i Këshillit të prokurorëve publik, Trajnim i avancuar për Ligjin e ri për PP, Modul: 3 Seanca Kryesore-Doracak – viti 2013.




### Fjalim hyrës

Sipas perceptimit të vëzhguesve në 11 raste të fjalimit hyrës të PPK është kuptuar se çfarë ka pohuar ai dhe cilat fakte përfundimtare do të dëshmohen. Në 1 rast nga fjalimi hyrës i PPK aspak nuk është kuptuar se çfarë është pohuar, ndërsa në 4 raste është kuptuar vetëm pjesërisht se për çfarë bëhet fjalë. Sa i përket fjalimeve hyrëse të prokurorit, sipas perceptimit të vëzhguesve në 6 raste nga fjalimi hyrës i prokurorit është kuptuar se çfarë pohon ai dhe cilat janë faktet përfundimtare që do të dëshmohen. Në 5 raste është kuptuar vetëm pjesërisht se për çfarë bëhet fjalë, ndërsa në asnjë rast nuk është vërejtur se prokurori ka bërë fjalim hyrës të pakuptimtë

Në 4 raste në të cilat personi i akuzuar ka bërë fjalim hyrës, në 2 prej tyre është kuptuar vetëm pjesërisht se për çfarë bëhet fjalë, ndërsa 2 fjalimet tjera hyrëse janë vlerësuar si të pakuptimta.

Është vërejtur se gjykatësi në disa lëndë e ka ndaluar fjalimin hyrës të palëve në procedurë me argumente se hyjnë në diskutim për politikën.



*Të kuptuarit e fjalimit hyrës të PPK/prokurorit, avokatit mbrojtës dhe personit të akuzuar*

### 2.1.5. Të drejtat e personit të akuzuar

Të drejtat e personave të akuzuar janë pjesë e parimit të gjykimit fer dhe të drejtë. Në KEDNJ si të drejta minimale të personit të akuzuar janë: personi të jetë menjëherë i informuar në detaje në gjuhën të cilën e kupton për natyrën dhe arsyet e akuzës, të ketë

kohë të mjaftueshme dhe kushte adekuate për përgatitjen e mbrojtjes, të ketë të drejtë të mbrohet vet ose me avokat mbrojtës sipas zgjedhjes së tij, ose në qoftë se nuk ka mjete të mjaftueshme për avokat mbrojtës atëherë të fitojë të drejtën për mbrojtës me detyrë zyrtare, të dëgjojë dëshmitarët, si dhe të ketë përkthyes në qoftë se nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën zyrtare të gjykatës. Në mënyrë të ngjashme edhe Konventa ndërkombëtare për të drejtat qytetare dhe politike e rregullon problematikën për të drejtat e personave të akuzuar. Në fakt, KNDQP<sup>26</sup> **vërteton se “çdokush që është i akuzuar për vepër penale ka të drejta të barabarta që të merr pjesë në gjykim, të mbrohet vet ose me ndihmën e avokatit mbrojtës, si dhe t’i sigurohet avokat mbrojtës pa pagesë në qoftë se vet nuk ka mundësi ta paguaj.” në të drejtat e akuzuarit merr pjesë edhe prania e tij në gjykim, dhe nga ana e vëzhguesve ka qenë e konstatuar se vetëm në 1 rast i akuzuari ka qenë i larguar në disa nga fazat e gjykimit.**


Zhvillimi i mëtejshëm i procedurës pas fjalimeve hyrëse vazhdon me një mesim për personin e akuzuar, gjegjësisht në pajtueshmëri me nenin 380 paragrafi 1 pas fjalimit hyrës të gjykatës, Gjykata e pyet të akuzuarin se a e kupton i akuzuari se për çfarë është i akuzuar. Nëse Gjykata konstaton se i akuzuari nuk e kupton akt akuzën në mënyrë të kuptueshme e nxjerr përmbajtjen e akt akuzës.

*Përfundim: Nga lëndët e vëzhguara mund të vërehet se në 19 raste gjykata e ka pyetur të akuzuarin nëse e kupton përmbajtjen e akt akuzës, ndërsa në 1 rast është vërejtur se gjykata ka bërë lëshim në lidhje me këtë.*

Në qoftë se gjatë kësaj pyetje personi i akuzuar thotë se nuk e kupton përmbajtjen e aktakuzës, gjykata ka për obligim të jep sqarim për veprën penale, nga të dhënat e marra personi i akuzuar në 2 raste nuk e kuptuar përmbajtjen e akt akuzës, në të cilën gjykata në 1 rast ka dhënë sqarim, ndërsa në rastin tjetër nuk ka dhënë sqarim, gjegjësisht **gjykatësi vetëm është përgjigjur se “gjithçka është e shënuar në akt akuzë.”**

Gjykata ka për detyrë të udhëzojë të akuzuarin për të drejta e tij në procedurë. Parimet gjegjësisht të drejtat të cilat kanë të bëjnë me të drejtën e avokatit mbrojtës dhe të drejtën për përkthyes janë të shënuara në LPP, ndërsa në nenin 380, paragrafi 2 konstatohet se gjykata i jep udhëzim të akuzuarit për të drejtën e heshtjes ose të jep deklaratën e tij dhe e këshillon që me vëmendje ta ndjek zhvillimin e seancës kryesore, **dhe i tregon se mund të jep dëshmi në mbrojtjen e tij, t’u parashtrojë pyetje të akuzuarve tjerë, dëshmitarëve dhe ekspertëve, dhe të bëjë shënime në lidhje me dëshmitë e tyre.**

<sup>26</sup> Pakti Ndërkombëtarë për të Drejtat Civile dhe Politike, viti 1996



Udhëzim për të drejtat

*Përfundim: Nga rezultatet e fituara mund të shihet se në 13 raste personit të akuzuar i është dhënë udhëzim për të drejtën e mbrojtjes, në 11 raste e drejta për përkthyes, në 10 raste e drejta që të deklarojë dhe të jep dëshmi në mbrojtjen e tij, në 9 raste personi **i akuzuar i është dhënë udhëzim për heshtje dhe t'u parashtrorë pyetje dëshmitarëve dhe ekspertëve** dhe në 8 raste e drejta për të dhënë vërejtje.*

Mund të vërehet se në numrin më të madh të lëndëve të monitoruar nuk ka të dhëna për udhëzim për të drejtat, duke pasur parasysh se janë vëzhguar 75 lëndë, gjë që përsëri tregon në përfshirjen e mëvonshme, gjegjësisht vëzhgimin e fazës së mëtutjeshme të procedurës, si dhe të 39 lëndëve të cilat gjatë kohëzgjatjes së periudhës së monitorimit ende nuk filluan, gjegjësisht ishin anuluar në mënyrë konstante. Në këtë drejtim që të mund të elaborohet çështja udhëzimit për të drejtat e personit të akuzuar si njëra nga parimet për gjykimin fer dhe të drejtë, e nevojshme është që vëzhgimi i procedurave të fillojë nga faza fillestare, gjegjësisht vëzhgimi ta mbulojë edhe seancën kryesore. Megjithatë udhëzimi për të drejtat e personave të akuzuar duhet të mbahet në mënyrë të plotë, gjykatësit më shpesh ose e tregojnë nenin nga LPP në të cilin janë specifikuar të drejtat e personave të akuzuar ose vetëm pjesërisht i tregojnë të drejtat pa mos e specifikuar çdo të drejtë veç e veç. Kjo praktikë është vërejtur veçanërisht gjatë seancave në të cilat personat e akuzuar kanë avokatë mbrojtës. Megjithatë, kjo nuk duhet të bëhet praktikë e lejueshme e gjykatësve pasi që treguarit e të drejtave të personave të akuzuar është parakusht thelbësor për të miratuar gjykimin ligjor në bazë të gjykimin fer dhe të drejtë.

E drejta për mbrojtje parasheh kohë të mjaftueshme për përgatitje, dhe e rëndësishme është të dihet se a është ankuar mbrojtja se nuk ka pasur kohë të mjaftueshme për përgatitjen ose ka pasur restriksione të caktuara, si dhe a ka qenë sipas perceptimit të vëzhguesve **mbrojtja e përgatitur që t'i përfaqësojë klientët e vet në mënyrë të përshtatshme**. Sipas të dhënave nga 1 rast është vërejtur ku mbrojtja nuk ka lënë

përshtypje për përfaqësimin e përshtatshëm të klientëve dhe ku mbrojtja është ankuar për shkak të mungesës së kohës së mjaftueshme për përgatitje të mbrojtjes.

Sistemi juridik tek ne e garanton të drejtën e heshtjes, por nuk ka theksuar mekanizëm të parashikueshëm se si ndikon heshtja në gjykatë. Sipas vlerësimit të vëzhguesve, në 1 rast gjykata tërhoqi përshtypje negative nga përdorimi i të drejtës për heshtje, që nuk është lehtë të arrihet në përfundim në rastet kur gjykata atë nuk do ta shpreh, dhe përfundimet do të mund të arrihen nga analizat e mëtejshme të numrit të vendimeve gjyqësore në rastet kur i akuzuari e ka përdorur këtë të drejtë

Sa i përket të drejtës për ndihmë juridike falas vetëm në 1 rast personit të akuzuar i është dhënë udhëzim për këtë mundësi. Edhe pse LPP parasheh se në të drejtat e të akuzuarit (neni 70), i akuzuari ka të drejtë të merr avokat mbrojtës falas, në qoftë se nuk ka mjete të paguaj, ndërsa këtë e kërkon interesi i drejtësisë, si dhe rëndësia e veprës penale dhe ndërlikueshmëria e rastit, ndërsa parashihet edhe mbrojtja e të varfërve. E drejta për ndihmë juridike falas varret nga përmbushja e dy kushteve kumulative: personi të mos mund të kompensojë koston e mbrojtjes së tij dhe ndihma juridike falas zë jetë në interes të drejtësisë.

*Përfundim: I vogël është numri i rasteve kur personi ka qenë i udhëzuar për të drejtën e ndihmës juridike. Sipas kësaj gjykatat jo përherë kontrollojnë se a është financiarisht i aftë të mbulojë koston për mbrojtje dhe se reagojnë më shpesh në rastet kur ligji parashikon mbrojtje të detyrueshme.*


KEDNJ konstaton se që të mund të realizohet gjykim fer dhe i drejtë i akuzuari duhet të ketë përkthyes pa pagesë në qoftë se ai nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën zyrtare të gjykatës, gjegjësisht ka të drejtë për përkthyes. Nga të dhënat e fituara në 22 raste i akuzuari ka pasur nevojë për përkthyes dhe i është siguruar menjëherë, në 4 raste ekziston dyshim për cilësinë e përkthimit. Në 1 rast gjatë kundërshtimit të përkthyesit, gjykatësi ka bërë zëvendësimin e përkthyesit. Përkthimi cilësor ka rëndësi të veçantë për procedurën fer dhe të drejtë, pasi që përkthyesi jo vetëm që përkthen deklaratat e folura në procedurë, por përkthen edhe dokumente dhe materiale tjera të shkruar, ndërsa përkthimi cilësor mundëson edhe barazinë e mjeteve në procedurë. Përkthimi i saktë është parakusht i nevojshëm për të drejtën e gjykimit të drejtë. Gjithsesi sistemi jonë nuk parasheh mundësi për diskutimin e përkthimit si jo kompetent ose të anshëm siç e sheh atë Direktiva Evropiane për të Drejtën e Përkthyesit.

Përfundim – Dyshimi i cilësisë së përkthimit që është paraqitur në 4 raste edhe atë raste me rëndësi për publikun e zbehin gjithë procesin e gjykimit fer dhe të drejtë.

#### 2.1.6. Pranimi i fajësisë

Me Ligjin e ri për PP u parashikua risi në lidhje me mundësinë e pranimit të fajësisë edhe në seancën kryesore, dhe atë pas fjalimeve hyrëse të palëve, ndërsa para fillimit të seancës dëshmuese. I akuzuari mundet vullnetarisht ta pranojë fajësinë në lidhje

me një ose më shumë vepra penale të akt padisë. Pranimi nuk është i kufizuar as me natyrën e as me rëndësinë e veprës penale për të cilën zhvillohet procedura, që do të thotë se i akuzuari mund të pranojë fajësinë për cilëndo vepër penale dhe të ngarkohet për cilëndo vepër penale.<sup>27</sup> Gjykata thërret personin e akuzuar që të shprehet në lidhje me veprat penale të akt padisë se a ndjehet fajtor ose jo. Personi i akuzuar në qoftë se pranon fajësinë, në rrjedhën e mëtejshme të procedurës do të zhvillohen vetëm dëshmitë të cilat kanë të bëjnë me vendimin e sanksionit.<sup>28</sup> Pranimi i fajësisë duhet të bëhet vullnetarisht dhe me vet obligimin që këtë gjë gjykata duhet ta hetojë sigurohen të drejtat e personit të akuzuar. Me rëndësi të veçantë është që personi i akuzuar ta kuptojë plotësisht veprën, por edhe pasojat që dalin nga pranimi i fajësisë, pasi që gjatë pranimi të fajësisë aktvendimi nuk mund të ankimohet për shkak konstatimit të gabueshëm të gjendjes faktike



Në rast të pranimi të fajësisë gjykata ka për obligim të hetojë se a është pranimi i fajësisë me vullnetin e të akuzuarit, se a është i akuzuarit i vetëdijshëm për pasojat ligjore të pranimi të fajësisë, si dhe pasojat të cilat kanë të bëjnë me kërkesat pronësore ligjore dhe shpenzimet e procedurës.

*Përfundim: Sipas të dhënave të lëndëve të vëzhguara në 13 lëndë personi i akuzuar ka pranuar fajësinë. Në 10 prej tyre janë parashtruar pyetje për pranimin a fajësisë në mënyrë vullnetare, ndërsa në 8 raste janë parashtruar pyetje që bëhet kontrollë për pranimin e fajësisë në drejtim të karakteristikave të veprës penale dhe vetëdijesimit të personit të akuzuar për pasojat juridike të pranimi të fajësisë. Të dhënat e fituara në këtë mënyrë del se në 3 gjegjësisht 5 lëndë sipas perceptimit të vëzhguesve gjykatësit nuk i kushtojnë vëmendje kontrollimit të këtyre fakteve kryesore dhe të rëndësishme gjatë pranimi të fajësisë.*

<sup>27</sup> Buzharovska, Gordana “Zgjidhja e fajësisë: doracak për praktikues” [Gordana Buzharoskam Majkëll g. Karnavas, Dejvid Re], Shkup: OSBE, 2010.

<sup>28</sup> Më shumë për vendime gjyqësore për shkak të pranimi të fajësisë në Kapitullin 3 – Analiza e politikës ndëshkuese



Në krahasim me vitin e kaluar, duket se gjatë këtij viti shumë më pak kujdes i është dhënë kontrollit të hollësishëm të vet vullnetit, vetëdijes dhe karakteristikave të veprës penale, për shkak se të dhënat nga viti i kaluar tregojnë se në të gjitha rastet e pranimit të fajësisë këto pyetje janë parashtruar.

Reagimi i tepruar nga ana e gjykatësve dhe avokatëve ka shkaktuar që shënimet gjegjësisht përfundimin që kemi bërë edhe vitin e kaluar sipas të cilit gjykatësit dhe jo shpesh edhe avokatët mbrojtës bëjnë presion nda personave të akuzuar që ta pranojnë fajësinë

*Përfundim: Shënimet më të shpeshta të vëzhguesve/eve janë se jashtë seancës gjykatësit para se të fillojnë të njëjtën tregojnë se në qoftë se i akuzuari e pranon fajësinë ai do të merr dënim më të vogël – të cilin e caktojnë në atë moment, dhe në qoftë se nuk e dënojnë me dënim të ashpër – të cilin gjithashtu e caktojnë në atë moment.*

Në qoftë se merret parasysh se pyetja për pranimin e fajësisë ndodh në seancën e parë kryesore pas mbajtjes së fjalimeve hyrëse, vijmë deri tek e dhëna se gjykatësi ka qëndrim të formuar për vendimin gjyqësor dhe sanksionet para se të fillojë lënda. Më shumë se evidente është se kjo situatë ndodh shumë shpesh, dhe është drejtpërdrejt në kundërshtim me dispozitat ligjore si dhe me parimet kushtetuese të prezumimit të pafajësisë. Në vend që të shqetësohemi se kush do ta specifikojë këtë në raport ose jo, më mirë është të shqetësohemi se përse kjo ndodh në përgjithësi.

## 2.2. SEANCA DËSHMUESE

Me Ligjin e ri për PP procesi i gjithmbarshëm i paraqitjes së dëshmive nga marrja në pyetje e dëshmitarëve, ekspertëve dhe këshilltarëve teknik, si dhe marrja në pyetje e të akuzuarit, në qoftë se bëhet testimi i tij me propozimin e mbrojtjes, kalon në palët që i kanë propozuar këto dëshmi. Roli i gjykatës është minimizuar në pajtueshmëri me akuzën e procedurës penale.

### 2.2.1. Renditja e paraqitjes së provave

Seanca dëshmuese fillon me paraqitjen e dëshmive që janë të propozuara nga ana e prokurorisë, dhe të pranuar nga gjykata.

Në seancën kryesore, gjatë seancës dëshmuese, dëshmitë e propozuara paraqiten me rend të caktuar ligjor. Më së pari paraqiten dëshmitë në bazë të të cilave bazohet akuzat dhe dëshmitë të cilat kanë të bëjnë me kërkesën pronësore-ligjore, e pastaj vijon paraqitja e dëshmive të propozuara nga mbrojtja. Pas paraqitjes së dëshmive të mbrojtjes, me Ligjin e ri për PP është dhënë mundësia për të paraqitur dëshmi të cilat do të hedhin poshtë dëshmitë e mbrojtjes – e ashtuquajtur replikë, ndërsa pastaj vijon


paraqitja e dëshmimeve nga ana e mbrojtjes, si përgjigje ndaj përgënjeshtimit – e ashtuquajtur përgjigje ndaj replikës.

*Përfundim: Nga rezultatet e fituara nga vëzhguesit është vërtetuar se në raste kur janë paraqitur dëshmi në të gjitha rastet gjegjësisht në gjithsejt 17 lëndë është vërejtur renditja ligjore e paraqitjes së dëshmimeve.*

### 2.2.2 Testimi i drejtpërdrejtë, i kryqëzuar dhe shtesë

Gjatë paraqitjes së dëshmimeve testimi mund të jetë i drejtpërdrejtë, i kryqëzuar dhe shtesë. Testimin i drejtpërdrejtë e bën pala e cila e ka propozuar dëshmitarin, gjegjësisht ekspertin, testimin e kryqëzuar e bën pala kundërshtuese, ndërsa testimin shtesë e bën përsëri pala e cila ka propozuar dëshmitarin ose ekspertin. Pyetjet të cilat indikojnë përgjigje janë të lejueshme gjatë testimit të kryqëzuar, ndërsa gjatë testimit të drejtpërdrejtë dhe shtesë vetëm për shkak të qartësisht të asaj që është thënë paraprakisht.

Tek testimi i drejtpërdrejtë u parashtrohen pyetje dëshmitarëve të tyre, të cilat janë të shkurtra me qëllim që të marrin përgjigje më të zgjeruara, ndërsa dëshmitarët duhet të përgatitin testimin, pasi që testimi i drejtpërdrejtë është bazë për testimin e mëtutjeshëm të kryqëzuar. Gjatë testimit të drejtpërdrejtë pritet sqarimi i personit që merret në pyetje, gjatë të cilit është e nevojshme të jepen përgjigje se kush është kryerës i veprave kriminale, ku dhe kur ka ndodhur rasti, si është kryer vepra penale, cili është motivi i kryerjes, cilat janë pasojat e veprës, gjegjësisht çfarë pasoja të dëmshme kanë ndodhur pas ekzekutimit të saj. Me rëndësi të veçantë gjatë testimit të drejtpërdrejtë janë pyetjet që i parashtrohen dëshmitarit, gjegjësisht ekspertit të jenë të qarta dhe precize. Gjithashtu këtë vit shtuam dy pyetje të reja të cilat kanë të bëjnë me udhëzimin e të drejtave të dëshmitarit dhe dhënien e betimit. Në 20 raste kur janë marrë në pyetje dëshmitari ose eksperti, në 95% gjegjësisht në 19 raste dëshmitari ka qenë i udhëzuar për të drejtat e tij, ndërsa në 5% ose në 1 rast nuk ka qenë i udhëzuar. Dëshmitari ka dhënë betimin në 11 raste nga 20 rastet.




*Dëshmitari është udhëzuar për të drejtat e tij*

*Përfundim: nga lëndët e vëzhguara është vërejtur se në 20 lëndë kur është përdorur testimi i drejtpërdrejtë i dëshmitarit/ekspertit në 19 prej tyre pyetjet kanë qenë të qarta dhe precize, ndërsa vetëm në një lëndë pyetjet kanë qenë pjesërisht të qarta dhe precize.*

Interesante është e dhëna e cila ka të bëjë me përgatitjen e prokurorisë dhe mbrojtjes për testim të drejtpërdrejtë. Në 2 vitet e fundit kemi rritje të numrit të lëndëve në të cilat mbrojtja është e përgatitur në mënyrë adekuate gjatë parashtrimit të pyetjeve të drejtpërdrejta, gjegjësisht nga 8 lëndët në të cilat mbrojtja ka bërë testim të drejtpërdrejtë, në 6 prej tyre ka lënë përshtypje se mirë e zotëron rastin, në 2 lëndë vetëm pjesërisht e zotëron rastin. Ndërsa, sa i përket përgatitjes së prokurorisë nga 20 rastet në 13 raste prokuroria ka lënë përshtypje se e zotëron rastin, në 5 prej tyre se vetëm pjesërisht e zotëron rastin dhe në 1 rast PPK ka dhënë përshtypje se nuk e zotëron rastin, ndërsa kjo përqindje nuk është paraqitur tek mbrojtja.

*Përfundim: Mbrojtja ka treguar se është më e përgatitur se prokuroria në testimin e drejtpërdrejtë.*



*Përgatitja e prokurorisë dhe mbrojtjes për testimin e drejtpërdrejtë*

Është vënë re se testimin e drejtpërdrejtë ndonjëherë e përdor edhe pala e kundërshtuese, dhe gjykata këtë gjë e lejon, për shembull, gjykata u jep leje edhe mbrojtjes edhe PPK të parashtrorin pyetje të drejtpërdrejta edhe pse bëhet fjalë për dëgjim të dëshmitarëve ose ekspertëve në propozim të palës kundërshtuese.

Me konceptin e ri të LPP është i nevojshëm roli aktiv i palëve në pjesën për përgatitje dhe prezantim të dëshmimeve para gjykatës. Përveç testimit të drejtpërdrejtë dhe shtesë, risi është edhe testimi i kryqëzuar i cili kërkon respektimin e rregullave për lejueshmërinë dhe relevancën e dëshmimeve pa marrë parasysh se për cilën palë bëhet fjalë në procedurë.<sup>29</sup> Testimi i kryqëzuar ka të bëjë me atë që ka thënë dëshmitari gjatë testimit të drejtpërdrejtë. Qëllimi i testimit të kryqëzuar është zvogëlimi i vlerës së deklaratave të


<sup>29</sup> Buzharovska Gordana dhe tjerë, "Testimi i kryqëzuar, doracak për praktikues"- Shkup, OSBE 2010

cilat i ka dhënë dëshmitari në testimin e drejtpërdrejtë, gjegjësisht mundësia për të hedhur poshtë deklaratat të caktuara ose të relativizohen veprime të caktuara. Testimi i kryqëzuar kërkon përgatitje të veçantë, bashkëpunim me avokatin me qëllim të përgatitjes për pyetjet e kryqëzuara. Me rëndësi është se testimi i kryqëzuar mund edhe të mos zbatohet, në qoftë se avokati mbrojtës vlerëson se ajo është në interes të mbrojtjes. Nga të dhënat e vëzhguesve është vërejtur se testimin e kryqëzuar njëloj e kanë përdorur edhe LPP edhe mbrojtja.

*Përfundim: Të dhënat deri tek të cilat kemi arritur gjatë analizës së testimit të kryqëzuar janë se ekziston përmirësimi, gjegjësisht zotërimi i kësaj risie nga ana e LPP dhe mbrojtjes gjatë së cilës parashtrihen pyetje të mbyllura, testimi bëhet në atë drejtim që të zvogëlohet vlera dëshmuuese e deklaratës të cilën e ka dhënë dëshmitari gjatë testimit të drejtpërdrejtë dhe jo të degradohet vet dëshmitari.*

Njëra nga poentat e përdorimit të testimit të kryqëzuar është që e njëjti të zhvillohet pa ndërprerë që të mund të dëshmohet qëllimi i pyetjeve. Në krahasim me vitin e kaluar ndërprerjet janë të evidentuara më rrallë edhe atë vetëm në 2 raste, gjegjësisht 18%, ndërsa arsyeja e kësaj është fakti se incizimi audio-vizual i lëndëve ende nuk është zbatuar në pajtim me ligjin e ri për PP.

Në 8% nga lëndët e monitoruara është vërejtur se gjatë testimit janë përdorur deklaratat të dhënë paraprakisht, ku skema ligjore tek testimi i kryqëzuar lejon që pyetjet të përmbajnë kujtesë të asaj që e ka thënë dëshmitari gjatë testimit të drejtpërdrejtë, dhe në 3 raste deklaratat e dhëna paraprakisht janë përdorur për shkak të mospërputhjes me deklaratën.



*Shfrytëzimi i deklaratave të dhëna paraprakisht*


Edhe pse testues kryesorë në procedurë janë palët, përsëri gjykata mund të parashtrorë pyetje, por me vet përfundimin e testimit nga palët. Në këtë pjesë gjykata ka përdorur të drejtën për t'i parashtruar pyetje dëshmitarit, gjegjësisht ekspertit në 17 raste.

### 2.2.3. Lejueshmëria e pyetjeve dhe ankesave

Gjykata ka për detyrë të kontrollojë mënyrën dhe orarin e marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe paraqitjes dëshmive, duke u kujdesu për efikasitetin e procedurës, mund të refuzojë paraqitjen e dëshmisë për të cilën konsideron se është e panevojshme, të miratojë testim të kryqëzuar, të kujdeset për lejueshmërinë e pyetjeve, testimin e drejtpërdrejtë dhe arsyeshmërinë e ankesave, si dhe për dinjitetin e palëve, të akuzuarit, dëshmitarëve dhe ekspertëve.

Sa i përket intervenimit të gjykatës në drejtim të lejueshmërisë së pyetjeve, në 74% të lëndëve është vërejtur se gjykata është kujdesur për lejueshmërinë e pyetjeve, validitetin e përgjigjeve dhe testimin e drejtpërdrejtë, në 26% të lëndëve gjykata nuk ka pasur nevojë të ndërhyjë.

*Përfundim: Për dallim nga viti i kaluar në këtë pjesë vërejmë përmirësim, pasi që gjykata në më shumë lëndë është kujdesur për lejueshmërinë e pyetjeve, si dhe fakti që nuk është vërejtur asnjë rast kur gjykata nuk është kujdesur.*




*Gjykata është kujdesur për lejueshmërinë e pyetjeve, validitetit të përgjigjeve dhe testimin të drejtë*

Gjykata mund të veprojë edhe me ankesën e lëndëve edhe me vendim që të ndalojë pyetje dhe përgjigje në pyetjen që është parashtruar, në qoftë se e vlerëson si të papranueshme ose irelevante, si dhe të ndalojë parashtrimin e pyetjeve të cilat në vetë përmbajnë edhe pyetje edhe përgjigje, përveç gjatë testimin të kryqëzuar.

*Përfundim: Të dhënat nga vëzhgimi tregojnë se edhe mbrojtja edhe LPP e përdorin ankesën për pyetjet.*

Më konkretisht, mbrojtja është ankuar në 9 raste, edhe atë në të gjitha rastet në pyetjet e LPP, ndërsa LPP ka është ankuar në 11 raste, edhe të në të gjitha rastet në pyetjet e parashtruara nga ana e mbrojtjes. Vitin e kaluar të dhënat ishin të shumëllojta, pasi që ankesat ishin të drejtuara edhe nga prokuroria edhe nga mbrojtja drejt palës

kundërshtuese, por edhe drejt pyetjeve të gjykatës. Megjithatë, të dhënat se këtë vit nuk ka ankesa ndaj pyetjeve të gjykatës janë më së shumti për shkak se gjykata më rrallë parashtron pyetje, që në frymën akuzuese të procedurës është një indikator i mirë për përmirësimin e praktikës së pasivitetit të gjykatës.



*Ankesat ndaj pyetjeve*

Edhe pse LPP e rregullon parimin e menjëhershmerisë, megjithatë parashikon edhe përjashtime në dëshminë e seancës kryesore. Në pajtueshmëri me ligjin, dëshmimi i një fakti bazohet në deklaratën e ndonjë personi dhe ajo duhet personalisht të shqyrtohet në seancën kryesore, përveç rasteve kur merret në pyetje dëshmitari i mbrojtur, ndërsa deklaratat e dhëna të dëshmitarëve gjatë procedurës hetimore dhe deklaratat e mbledhura në kuadër të veprime të mbrojtjes gjatë procedurës hetimore mund të përdoren gjatë testimit të kryqëzuar ose gjatë përgënjeshtimit të akuzave të paraqitura ose në përgjigje të përgënjeshtimit, për të vlerësuar vërtetësinë e deklaratave të dhëna në seancën kryesore.

Nenin **388 paragrafi 3** konstaton se **“Në qoftë se pas fillimit të diskutimit kryesor paraqiten indikacione në bazë të së cilave mund të konkludohet se dëshmitari i është nënshtruar dhunës, kërcënimit, premtimit të parave ose përfitimeve tjera që të mos dëshmojë ose të dëshmojë rrejtshëm në diskutimin kryesor, deklaratat e dhëna të dëshmitarit para prokurorit publik në procedurën paraprake me vendimin e gjykatës mund të paraqiten si dëshmi.”**<sup>30</sup>


Gjithashtu, ekziston një përjashtim kur personi që ka dhënë deklaratën ka vdekur, është sëmurë mendërisht ose është i paarrtshëm. Në pyetjen se a është zbatuar neni 388 i LPP, nga të dhënat e vëzhgimit vetëm në 4 raste ka pasur përjashtim në dëshmi në seancën kryesore, ku kanë qenë të lexuara deklaratat e dëshmitarëve.

#### 2.2.4. Barazia e armëve

Në definimin e gjykimit të drejtë veçanërisht e rëndësishme është barazia e armëve që nënkupton mundësitë e njëjta të palëve në prezantimin e dëshmimeve, si dhe trajtimin e njëjtë nga ana e gjykatës. Kjo do të thotë se çdonjëra nga palët në procedurë

<sup>30</sup> Ligji për Procedurë Penale, Gazeta Zyrtare e R.M., nr. 150 nga 18.11.2010

duhet të ketë mundësi të arsyeshme për paraqitjen e rastit të vet para gjykatës, gjegjësisht se njëra palë nuk do të vendoset në situatë më të pafavorshme në raport me palën tjetër. Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, tregon se barazia e armëve do të thotë se palët në mosmarrëveshje të kenë pozitë të njëjtë procedurale gjatë kohës së gjykimit dhe të kenë pozitë të njëjtë në pjesën e paraqitjes së mbrojtjes ose akuzës.<sup>31</sup> Në procedurat penale barazia e armëve është garanci për të drejtën e mbrojtjes. Principi kërkon kohë të mjaftueshme, si dhe mundësi për përgatitjen e mbrojtjes, por përfshin edhe të drejtën për avokat, të drejtën që të propozohen dhe të merren në pyetje dëshmitarë dhe e drejta e të akuzuarit të jetë prezent gjatë kohës së gjykimit.



*Mbrojtja dhe prokurori ishin të trajtuar barabartë nga ana e gjykatësit në lidhje me ankesat dhe ngjashëm*

Në pyetjen se a kanë qenë të trajtuar barabartë mbrojtja dhe prokurori nga gjykata në lidhje me ankesat dhe veprimet tjera gjatë procedurës në 95% të rasteve është dhënë përgjigje pozitive, ndërsa vetëm në 5% të rasteve është dhënë përgjigje se mbrojtja dhe prokurori nuk kanë qenë të trajtuar barabartë. Është vërejtur se kur prokurori largohet nga salla e gjykimit gjykatësi nuk e dënon për shkak të sjelljes së tillë, ndërsa kur mbrojtja e largohet nga salla e gjykimit, gjykata vazhdimisht i gjobon për shkak të mosrespektimit të gjykatës dhe i angazhon me tarifa gjyqësore për seancat. Janë interesante të dhënat se ekziston trajtim i ndryshëm nga ana e gjykatës për prokurorët publik të LPP dhe prokurorët publik të PSP. Do të thotë, kur PSP kërkoi fotokopje të dëshmimeve për lëndën që është nën juridiksionin e saj, gjykata kërkesën e tillë e refuzoi, kjo është një gjë që asnjëherë nuk ndodh kur LPP kërkon dëshmi.<sup>32</sup> Të dhënat e tilla tregojnë respektimin selektiv të principit të barazisë së armëve dhe gjykimit të drejtë, që është një trend interesant duke pasur parasysh se tek modeli i mëparshëm i procedurës penale vërejtjet më të mëdha kishin të bëjnë me trajtimin jo të barabartë të palëve, gjegjësisht të mendimit se gjykata gjithmonë është më e prirur për prokurorinë.


<sup>31</sup> "Gjykimi i drejtë, Doracak" / Fondi për të Drejtën Humanitare, Beograd, viti 2001

<sup>32</sup> Deri tek mbyllja e bazave të të dhënave gjatë kohës së kësaj periudhe të monitorimit PSP ishte e pranishme në gjykimin "Puçi",. Prej aty dalin këto të dhëna.

*Përfundimi: Kjo dashuri ndaj prokurorisë nga ana e gjykatës shënohet edhe në vërejtjet e vëzhguesve gjatë këtij viti, gjegjësisht shkelja e këtij parimi shpesh ndodh jashtë seancës. Për shembull, kur është thirrur prokuroria në sallën gjyqësore para se të thirret mbrojtja, kur prokurori nuk ka marrë pjesë në seancë dhe nuk e ka arsyetuar mungesën e vet, ndërsa gjykata nuk e ka dënuar.*

#### 2.2.5. Ekzaminimi i të akuzuarit

Me Ligjin e ri të PP i akuzuari mund të merret në pyetje vetëm në qoftë se ka propozim nga mbrojtja. Me këtë risi ligjvënësi është përpjekur që i akuzuarin bashkë me avokatin e tij të vendosë që si pjesë e mbrojtjes së tij a të merret në pyetje. Nga të dhënat e fituar në 5 raste i akuzuari është marrë në pyetje në seancën kryesore, ndërsa në 5 raste nuk është marrë në pyetje.




*Marrja në pyetje e të akuzuarit në lidhje me veprën penale*

Ndërsa në 4 raste i akuzuari është marrë në pyetje në lidhje me rrethanat të cilat janë të rëndësishme për përcaktimin e dënimit.

Ligji për procedurë penale parashikon që i akuzuari të mos jetë i detyruar që jep deklaratë kundër vetes ose të pranojë fajësinë, si dhe të shpreh mbrojtjen e tij. Për qëllim të kësaj, është e nevojshme që të bëhet dallim gjatë vëzhgimit për dhënien e dëshmisë dhe mbrojtjes, që nënkupton se dhënia e mbrojtjes nuk do të thotë dhënie të dëshmisë për rastin në të njëjtën kohë.

*Përfundim: Në 10 raste kur i akuzuari nuk ka pasur avokat mbrojtës, ekzaminimi është zhvilluar në mënyrë që në 5 raste vet ka treguar për akuzën në seancën kryesore, ndërsa në 5 raste është përgjigjur në pyetjet e gjykatës.*





*Mënyra e marrjes në pyetje e të akuzuarit i cili nuk ka pasur avokat mbrojtës*

Në raport me mundësinë që të përdoren dëshmitë e të akuzuarve nga procedura paraprake, duke i marrë parasysh edhe dëshmitë e dhëna në polici në n prani të prokurorit publik, në asnjë rast nuk është vërejtur se është shfrytëzuar kjo mundësi.


*Përfundim: Në këtë pjesë mund të konkludohet se gjykatat në thelb kanë një praktikë pozitive, duke pasur parasysh se qëllimi i ligjit të ri ka qenë që dëshmitë të zhvillohen në seancë publike dhe kontradiktore para gjykatës, ndërsa leximi i dëshmive nga procedura paraprake të shfrytëzohet vetëm si përjashtim.*

#### 2.2.6. Mënyra e paraqitjes së dëshmive materiale dhe atyre me shkrim

Prezantimi i dëshmive, gjegjësisht mënyra e paraqitjes së dëshmive materiale dhe atyre me shkrim në pajtueshmëri me Ligjin e ri për PP solli pasiguri në procedurë. Gjegjësisht, në pajtueshmëri me ndryshimet gjykata ra rol pasiv, kështu që PPK dhe mbrojtja kanë rol aktiv në procedurë gjatë dëshmimit të fajësisë nga ana e PPK dhe **gatishmërisë së mbrojtjes t'i përgjigjet PPK. Në pajtueshmëri me lëndët e vëzhguara në 6 lëndë**, gjegjësisht në 43% të rasteve dëshmitë në procedurë kanë qenë të paraqitura me lexim dhe të prezantuara nga ana e gjykatës, ndërsa në 4 raste me kërkesë të palës gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit, gjegjësisht ekspertit.

*Përfundim: Nga të dhënat e fituara në këtë mënyrë mund të konkludojmë se në pjesën më të madhe të dëshmive materiale dhe atyre me shkrim edhe më tutje i lexon dhe i prezanton gjykata, por jo palët në procedurë siç duhet të jetë në pajtueshmëri me Ligjin e ri për PP.*

Por, për dallim nga viti i kaluar, është vërejtur zvogëlim i numrit të lëndëve në të cila gjykata i lexon dhe i prezanton dëshmitë, që gjithsesi është një hap i ngadalshëm, por është një hap përpara në pajtueshmëri me Ligjin e ri për PP.




*Mënyra e paraqitjes së dëshmive materiale dhe atyre me shkrim*

### 2.2.7. Mënyra e regjistrimit të rrjedhës dhe paraqitjes së dëshmive

Ligji i ri i PP imponoi edhe parakushte materiale-teknike për shënimin e rrjedhës së seancës kryesore. Gjegjësisht, në nenin 374 është caktuar se rrjedha e seancës kryesore inçizohet me audio ose audio-vizual. Kur nuk ekzistojnë kushte teknike për inçizim audio ose audio-vizual të rrjedhës së seancës kryesore, kryetari i këshillit mund të urdhërojë që gjatë rrjedhës së seancës kryesore të bëhet regjistrimi stenografik i saj. Por, njëra nga vërejtjet kryesore mbeti në këtë drejtim, gjegjësisht edhe më tej gjykatat nuk kanë pajisje teknike të mjaftueshme që të mund të përdorin teknikat bashkëkohore për regjistrim.

Në fakt, të dhënat treguan se edhe më tej në numrin më të madh të rasteve regjistrimi i rrjedhës së seancës, si dhe paraqitja e dëshmive vërehet përmes regjistrimit me diktim nga ana e kryetarit të këshillit gjyqësor, gjegjësisht në 65% të rasteve ende gjykatat e përdorin këtë metodë. Në 28% të rasteve është vërejtur se rrjedha e seancës bëhet me regjistrim përmes diktimit nga ana e gjykatësit dhe futja e drejtpërdrejtë e pyetjeve dhe përgjigjeve nga testimi i drejtpërdrejtë dhe i kryqëzuar

*Përfundim: Pas gati 3 viteve që kur është zbatuar Ligji i ri i PP për herë të parë në 13 % të rasteve është vërejtur përdorimi i teknikës për regjistrim siç është incizimi audio-vizual. Ë Kjo e dhënë është nga seancat e lëndës Lagja e Trimave.*



*Si bëhet regjistrimi i rrjedhës dhe paraqitja e dëshmive në seancën kryesore*

### 2.2.8. Gjykimi i paanshëm


E drejta e gjykimit të paanshëm është gjithashtu njëra nga të drejtat të cilat mundësojnë gjykim fer dhe të drejtë. Që të mund të sigurohet gjykim i paanshëm është paraparë instrumenti i përjashtimit të gjykatësit ose anëtarëve të jurisë. E drejta e paanshmërisë së gjykatës kërkon që gjykatësit dhe anëtarët e jurisë të mos kenë interes nga mosmarrëveshja, gjegjësisht procedurat të zhvillohen fer dhe drejtë dhe të të respektohen të drejtat e të gjitha palëve në mosmarrëveshje. Komiteti për të Drejtat e Njeriut pranë Kombeve të Bashkuara shpreh se paanshmëria **“do të thotë që gjykatësi nuk duhet të ketë formuar paraprakisht mendim për rastin të cilin e udhëheq, si dhe se nuk duhet të veprojë në mënyrën që do të favorizojë interesat e njëjës palë në mosmarrëveshje.”**<sup>33</sup> Principet themelore për pavarësinë e gjyqësisë konstatojnë se **“gjykatësit duhet të sillen në mënyrë që të sigurojnë paanshmëri dhe pavarësi të gjykatës”**

Përjashtimi është mënyrë për të sfiduar paanshmërinë e gjykatës. Nga ana tjetër kjo pjesë ishte mbuluar me vëzhgimin gjatë të cilit të dhënat tregojnë se nuk ka pasur asnjë përjashtim me kërkesë të gjykatësit ose jurisë. Interesante janë të dhënat se në lëndët e vëzhguara është paraqitur një kërkesë për përjashtim të prokurorëve publik, gjegjësisht që lënda të kalojë nën juridiksionin e PSP. Pas kësaj kërkesë më nuk vendoste gjykata, pasi që për një lëndë që të kalojë nën juridiksionin e PSP është e nevojshme që nga PSP të dërgojnë raport që e marrin lëndën.

Në 95% të rasteve vëzhguesit kanë vlerësuar se gjykatësi ose anëtarët e jurisë nuk kanë formuar mendim i cili mund të ndikojë në vendimin, dhe në përqindje të njëjtë gjykatësit nuk i janë shmangur komunikimit të papërshtatshëm ex-parte.

<sup>33</sup> “Gjykim të drejtë, Doracak” / Fair Trials Manual, Fondi për të Drejtën Humanitare, Beograd 2001, - shiko rastin Kartunen kundër Finlandës (387/1989), Raport i Komitetit për të Drejta e Njeriut,

*Përfundim: në 5% të rasteve është vërejtur se gjykatësit ose anëtarët e jurisë nuk kanë formuar mendim i cili mund të ndikojë në vendimin si dhe në 8% të rasteve gjykatësit kanë përdorur komunikim të papërshtatshëm ex-parte i cili më shpesh është zhvilluar me prokurorin dhe me të akuzuarin jashtë seancës, shpjegim për mundësinë e pranimit të fajësisë.*



*Ekzistimi i komunikimit të papërshtatshëm ex-parte*

Nga të dhënat e fituara prej vëzhguesve nuk është vërejt përdorimi i gjuhës diskriminuese nga ana e gjykatës në baza gjinore, racore, dhe ngjashëm dhe në 2 raste vëzhguesit kanë pasur vërejtje në lidhje me gjykatën për rrjedhën e procedurës.

### 3. ANALIZË E POLITIKËS DËNUESE

Ligji i ri për PP përmban dispozita të cilat për së pari herë në legjisllacionin penal-procedural maqedonas e rregullojnë mundësinë për marrëveshje të prokurorit publik dhe të akuzuarit për llojin dhe kohëzgjatjen e sanksionit penal, parashikojnë status të ndryshëm të deklaratës për pranimin e fajësisë në fazën e kontrollit të akt akuzës, dhe të deklaratës së dhënë gjatë seancës kryesore në procedurën e rregullt, si dhe gjatë seancës në procedurën e shkurtuar që deri më tani ishte rasti me dëshminë që i akuzuari mundej ta jep para gjykatës.<sup>34</sup>

Vendimet e tilla ligjore sollën reformë thelbësore të veprimeve procedurale të cilat janë të bartura nga instituti anglo-sakson specifik për shtetet common law me përshtatjen e tyre të nevojshme drejt praktikës gjyqësore evropiane. E drejta e procedurës penale dhe praktika gjyqësore të cilat janë karakteristike për vendet tradicionale evropiane deri më tani kanë kundërshtuar të drejtën kontraktuese, gjegjësisht konsensuale duke filluar nga orientimi se reagimi penal është themeluar me ligj të rreptë dhe nuk nje dialog, kompromis, e as marrëveshje duke marrë parasysh faktin se qëllimi kryesor është

<sup>34</sup> "Doracak për Ligjin për Procedurë Penale", Ministria e Punëve të Brendshme, Biroja për Siguri Publike, qendra për Trajnim, Shkup 2012.

mbrojtja e vlerave sociale fundamentale. Në literaturën procedurale-penale një kohë të gjatë takohen akuzat se penalen e përzier e karakterizojnë, ngadalësia, formaliteti i shprehur, jo fleksibiliteti dhe, si rezultat i gjithë kësaj, jo efikasiteti. Pritet mundësia për marrëveshje që të kapërcehen vërejtjet e këtilla dhe të mundësohet që drejtësia penale të realizohet në afat sa më të shkurtër. Megjithatë, që të fillojë të funksionojë marrëveshja e nevojshme është që në këtë shtet të ekzistojë politikë penale stabile dhe të barabartë. Në R.M., që kur filloi të zbatohet Ligji i ri për PP nuk ekzistonte asnjëra, e as tjetra, kështu që të mbijetojë marrëveshja filloi qasja drejt krijimit të instrumenteve për barazi të politikës penale gjatë shpalljes së dënimeve. Në këtë drejtim Ministria e Drejtësisë gjatë vitit 2014 propozoi miratimin e një Rregulloreje për mënyrën e përcaktimit të dënimeve.<sup>35</sup> Miratimi i kësaj rregulloreje shkaktoi reaksione të shumëllojshme nga ana e të gjithë lexuesve në sistemin të drejtësisë. Derisa një pjesë e aktorëve ishin qëndrimin se rregullore e këtij lloji është e nevojshme për harmonizimin e politikës penale dhe nevojës për krijimin e mjeteve për unifikimin e politikës penale gjatë përcaktimit të dënimeve, i rëndësishëm është edhe grupi i ekspertëve i cili kritikonte ashpër miratimin e rregullores për arsye se e njëjta depërton në autonominë dhe pavarësinë e gjyqësisë e shprehur edhe përmes vendimit diskret për dënimet.<sup>36</sup> Pakënaqësia e dukshme rreth Rregullores për mënyrën e vlerësimit të dënimeve arriti kulminacionin kur u propozua miratimi i Ligjit për përcaktimin e llojit dhe vlerësimit të lartësisë së dënimit,<sup>37</sup> e veçanërisht me hyrjen e tij në fuqi dhe zbatimin e tij nga 06.07.2015.

Përfitimi më i madh, gjegjësisht kritika ndaj Ligjit për përcaktimin e llojit dhe vlerësimit të lartësisë së dënimit është në institutin e sapo futur në LPP – zgjidhja. Për fat të keq kjo analizë nuk mundet plotësisht të adresohet në zgjidhje, pasi që lëndët e vëzhguara janë vetëm lëndë të cilat gjenden në gjykatë, por jo edhe në fazat paraprake të procedurës veçanërisht gjatë procedurës hetimore të prokurorisë publike.

Ligji ka zbatim të dukshëm edhe rrjedhën seancës gjyqësore, gjatë pranimit të fajësisë dhe vlerësimit të dënimit nga ana e gjykatës.


Nga të dhënat e fituara nga lëndët e vëzhguara, nga 75 lëndë të monitoruara, kanë përfunduar 23 lëndë, ndërsa një e treta e lëndëve janë ende në rrjedhë.

---

<sup>35</sup> Rregullore për mënyrën e vlerësimit të dënimeve (Gazeta Zyrtare e R.M. nr.64/14)

<sup>36</sup> Gogov, Bogdanço, dr. "Reforma e politikës ndëshkuese ose diçka tjetër", 1.02 Pasqyrë e artikullit shkencor УДК343.19.077.6.04(497.7),

<sup>37</sup> Ibid.




*Numri i lëndëve të përfunduara*

Nga gjithsejt 23 vendime gjyqësore, 12 vendime janë sjellë nga ana e Departamentit për krim të organizuar dhe korrupsion, ndërsa 11 vendime kanë të bëjnë me lëndët tjera penale të cilat janë me rëndësi për publikun dhe lëndë tjera korruptive.

Pranimi i fajësisë si e drejtë e të akuzuarit nuk është diçka e panjohur dhe e re, por kjo gjë ishte parashikuar edhe në Ligjin e Vjetër për PP. Risia kryesore e cila vjen nga Ligji i ri për PP është në atë se tani në bazë të kësaj njohjeje dhe në kushte të caktuara me ligj, në seancën kryesore gjykata mund të sjellë aktvendim, pa pasur detyrim për të paraqitur prova shtesë. Nga kjo del se gjykata tani ka ndryshim të rëndësishëm në raport me vlerën dëshmuese të pranimit të fajësisë. Procedura për pranimin e fajësisë në seancën kryesore është rregulluar në nenet 380 dhe 382 të LPP. Është interesante se i akuzuari pranimin e fajësisë si dhe zgjidhjen mund ta jep pavarësisht nga natyra dhe pesha veprës penale për të cilën zhvillohet procedura. Gjithashtu, ai mund ta pranojë fajësinë në raport me një ose më shumë vepra penale të akuzës.

Nga lëndët e vëzhguara dhe 23 aktvendimet e marra të cilat kanë të bëjnë me gjithsejt 37 persona të akuzuar, 6 aktvendime janë sjellë në bazë të pranimit të fajësisë, 14 janë vendime gjyqësore me dënim dhe 3 janë vendime liruese. Sipas kësaj të dhëne, vendime gjyqësore janë sjellë në 20 raste dhe vetëm 3 vendime gjyqësore liruese. Në krahasim me vitin e kaluar është vërejtur zvogëlimi i numrit të aktvendimeve për shkak të pranimit të fajësisë. Por, megjithatë, ashtu si edhe vitin e kaluar nga perceptimi i vëzhguesve rezultoi vërejtja se personat e akuzuar gjatë sqarimit të kësaj mundësie nga ana e gjykatës njëjtë me vetëdije ose pa vetëdije me llogaritjen matematikore të sanksionit të parashikuar në rast të pranimit të fajësisë dhe në rast të vendimit gjyqësor dënues bën shtypje në vullnetin e lirë për pranim të fajësisë nga ana e personave të akuzuar.




*Llojet e vendime gjyqësore*

Gjykata më shpesh ka përcaktuar dënim me burg, gjegjësisht në 11 raste është caktuar dënimi me burg, i cili ka lëvizur nga minimumi 6 muaj e deri në maksimum prej 5 vjet e 6 muaj, në 1 rast është caktuar dënim me kusht. Gjykata ka në 1 rast ka caktuar masë dytësore – dëbim të një të huaji nga shteti. Shqetësues është fakti se gjykata nuk e ka zbatuar absolutisht masën për konfiskim të zgjeruar, pasi që nga kjo masë priten rezultate të rëndësishme në luftën çrrenjosjen e korrupsionit.

Principi tjetër i rëndësishëm gjatë sjelljes së vendimit gjyqësor është që i njëjti të caktohet publikisht, deri sa nuk ekzistojnë kufizime në atë aspekt. Sipas parimeve të KNDQP<sup>38</sup> përjashtim për caktimin publik të vendimit gjyqësor ekzistojnë kur bëhet fjalë për person të mitur privatësia e të cilit duhet të mbrohet, kur bëhet fjalë për mosmarrëveshje bashkëshortore, si dhe në rastet e kujdestarisë së fëmijëve. Caktimi i vendimit gjyqësor zbatohet publikisht edhe kur publiku është plotësisht ose pjesërisht i përjashtuar nga gjykimi.

Nga të dhënat e fituara të vëzhguesve mund të vërehet se në 8 lëndë ose 35% të rasteve gjykata nuk ka shqiptuar publikisht vendimin, ndërsa seancat për të publikuar vendimin në 90% të rasteve janë planifikuar për 3 ditë.



*Vendim i shpallur dhe i caktuar publikisht*

<sup>38</sup> Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe politike, viti 1966.

Me shpalljen e akt vendimit gjykata ka detyrë **dhe obligim t'i jep udhëzim** të akuzuarit për të drejtën e ankesës. Mjetet juridike janë veçanërisht të rëndësishme për vlerësimin e aspektit të qasjes së drejtësisë. Gjykata Evropiane thekson se, edhe pse në nenin 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk është shprehur e drejta për ankesë, megjithatë, ajo e drejtë është e pandashme nga e drejta për gjykim të drejtë. Kjo garanci është vërtetuar me nenin 2 të Protokollit 7 drejt Konventës në të cilin parashihet e drejta e ankesës në veprat penale. Në këtë drejtim të dhënat e vëzhguesve tregojnë se gjykata gjatë vendimit dënues të të akuzuarit ia ka sqaruar kushtet për ankesë.

Konstatimi përfundimtar për efikasitetin gjyqësor në luftë me krimin e organizuar dhe korrupsionin është se me ndryshimet e reja të LPP dhe institutit zgjidhje dhe pranim të fajësisë, numri i vendimeve është rritur shumë dhe kohëzgjatja e procedurave gjyqësore është zvogëluar. Nga ana tjetër me miratimin e Ligjit për caktimin e llojit dhe vlerësimin e lartësisë së dënimit, nevoja për implementim të të njëjtit përmes vendimit matematikor të gjykatësve për lartësinë dhe llojin e sanksioneve e degradon rolin e gjykatësve në aspektin e asaj se gjykata nuk është e lirë të sjell vendim për sanksionin që do të ishte i personalizuar dhe i përshtatshëm në çdo rast konkret.



## 4. PËRFUNDIMET GJENERALE

Pushteti gjyqësor është shtylla e tretë e një shteti demokratik. Derisa pushtet legjislativ dhe ekzekutiv funksionojnë përmes të ashtuquajturit sistem të aktivizuesit dhe frenuesit, pushteti gjyqësor vepron si kushtetutës dhe ligjeve. Që të ekzistojë sundimi i ligjit i nevojshëm është ekzistimi i pushteti të pavarur gjyqësor. Në Republikën e Maqedonisë sistemi gjyqësor sipas Raportit të Progresit për vitin 2016 ka përcaktuar nivel të caktuar të përgatitjes, por ka pasur kthim prapa në aspektin e pavarësisë dhe ndërhyrjes politike në punën e saj.

Sa i përket luftës me korrupsionin, gjithashtu është vërejtur se kornizat ligjvënese dhe institucionale kanë qenë të zhvilluara më shumë se një dekadë, por edhe këtë sferë vërehet ndërhyrja politike në punën e organeve. Korrupsioni mbetet i përhapur në shumë lëmi dhe vazhdon të jetë problem serioz.<sup>39</sup>

Prioritetet reformuese urgjente të cilat ishin të drejtuara për një periudhë urgjente dhe të sistematizuar drejt zgjidhjes së krizës politike, gati se nuk u aplikuan, përveç se formalisht në disa lëmi të caktuara, më e thirrur gjatë implementimit të këtyre prioriteteve ishte pushteti gjyqësor, që 2 vite me radhë shënon regres.

Ndërhyrja politike dhe varshmëria e institucioneve nda dëshira e pushtetit ekzekutiv nuk përfundon vetëm tek gjykatat dhe organet veprimtaritë e të cilave janë të drejtuara drejt shuarjes së këtij fenomeni kriminal. Me këtë përshtatet edhe ajo se Parlamenti nuk e kryen rolin e vet për sigurimin e kontrollit mbi punën e pushtetit ekzekutiv, gjyqësia nuk është e pavarur, ndërsa presion politik ka edhe në sektorët tjerë. Konkretisht, sistemi i aktivizuesit dhe frenuesit nuk funksionon, pushteti i tretë me radhë – gjyqësia është nën presion të ndërhyrjes politike, dhe vijmë në situatë të robërimit të shtetit në **institucionet, i ashtuquajturi “shtet i robëruar”**.

Sa i përket implementimit dhe përshtatshmërisë së sistemit gjyqësor drejt Ligjit të Ri për PP, përfundimet janë se edhe pas 3 viteve të hyrjes në fuqi të këtij ligji ekzistojnë dispozita të caktuara të cilat aspak nuk praktikohen, përshtatshmeri e ngadalshme drejt ndryshimeve të caktuara të cilat kanë të bëjnë para së gjithash me rolin e palëve në procedurë, ndërsa veçanërisht roli i gjykatës, si dhe sukseset e caktuara në aspektin e institucioneve të reja siç janë fjalimet hyrëse, testimi i drejtpërdrejtë dhe i kryqëzuar, pranimi i fajësisë dhe të drejtat e personave të akuzuar. Por, gjatë situatës në të cilën hapur dhe në bazë të argumenteve kritikohet gjyqësia në aspektin e pavarësisë së saj dhe jo efikasitetit, të një rëndësie dytësore është implementimi i ndryshimeve ligjore derisa të njëjtat miratohen dhe zbatohen në sistemin e skllavërisë dhe shtetit.

---

<sup>39</sup> Commission Staff Working Document

The former Yugoslav Republic of Macedonia 2016 Report

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2016/20161109\\_report\\_the\\_former\\_yugoslav\\_republic\\_of\\_macedonia.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2016/20161109_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf)

## 5. REKOMANDIMET

### Për shtetin

- Të përforcohen standardet e pavarësisë së gjykatësve si dhe krijimi i kushteve për veprim të pavarur pa presione politike dhe ndikime gjatë marrjes së vendimeve të tyre;
- Të depolitizohet sistemi i emërimit dhe promovimit të gjykatësve në praktikë, jo vetëm në ligj, por edhe të reformohet sistemi për procedura disiplinore dhe shkarkim të gjykatësve, në pajtueshmëri me rekomandimet e BE dhe Komisionit Venecian;
- Të sigurohet mbështetja e plotë dhe resurset e PSP;
- Të zhvillohet strategji serioze për reforma në gjyqësi dhe plani i veprimit për zgjidhjen e mangësive të mbetura në mënyrë të qëndrueshme;
- Zhvillimi i evidentimit ë besueshëm për luftë kundër korrupsionit të nivelit të lartë, duke përfshirë edhe kthimin e mjeteve.

### Për donatorët dhe organet shtetërore

- Vëzhgimet të mbulojnë procedurat deri në fund, gjegjësisht deri te sjellja e vendimeve të formës së prerë me qëllim që të arrihet në përfundim për efikasitetin e gjyqësisë dhe përgjigjen gjyqësore-penale në luftën me krimin e organizuar dhe korrupsionin;
- **Analizat e Koalicionit “Të gjithë për gjykim të drejtë” të përdore si** resurs dhe bazë për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve, pjesëmarrja e ekspertëve të Koalicionit në komitetet dhe grupet për ndryshime ligjore dhe miratim të politikave publike;
- Vazhdim të trajnimeve për konceptin e ri të LPP për prokurorët dhe Avokatët mbrojtës në aspektin e risive për testim të kryqëzuar, si dhe nevoja për qeverisje cilësore të rastit në procedurën dëshmuese.

### Për punën e gjykatave, prokurorinë dhe avokatët

- Forcimi i kontrollit të dorëzimit me qëllim të zbatimit të shpërndarjes së rregullt të ftesave, si dhe zbatimi i masave për siguri me qëllim të pjesëmarrjes së të gjithë pjesëmarrësve në procedurat;
- Sigurim i qasjes deri te dëshmitë e mbrojtjes, si dhe kohë të mjaftueshme për përgatitje, duke pasur parasysh se njëra nga të drejtat themelore të të akuzuarit është koha e mjaftueshme dhe mundësia për përgatitje të mbrojtje së vet, si dhe rishikim i dosjeve me qëllim të njohjes me dëshmitë kundër tij dhe në favor të tij.
- Gjatë udhëzimit për të drejtat e nevojshme është që gjykata të kontrollojë kushtet marrja e ndihmës ligjore falas dhe për të njëjtën të udhëzojë personat e akuzuar;

- Fjalimi hyrës të cilin e bëjnë palët në procedurë duhet të jetë i kuptueshëm dhe të mundësojë njoftim të qartë dhe konciz të gjykatës që pala ka për qëllim të tregojë, si dhe cilët fakte përfundimtare do të mundohet t'i dëshmojë.
- Dhe gjatë testimit të drejtpërdrejtë pyetjet duhet të jenë të qarta dhe precize, ndërsa tek testimi i kryqëzua të përdoren pyetje të tipit të mbyllur me të cilat merren në pyetje dëshmitarët të cilët i ka propozuar pala kundërshtarë;
- Pranimi i fajësisë si e drejtë e të akuzuarit për të shpjeguar dhe për të sqaruar nga ana e mbrojtësit para fillim të procedurës, gjatë së cilës i akuzuari në mënyrë të pavarur dhe pa presion do të vendos se a do ta shfrytëzojë këtë të drejtë;
- E drejta e të akuzuarit për heshtje që të mos ketë pasoja gjatë sjelljes së vendimit nga ana e gjykatës;
- Gjykata të sigurojë barabarësi të palëve në procedurë dhe të përmbahet nga mos **përshtatja e komunikimit ex parte me** prokurorinë;
- Gjykata vetëm me përjashtim të propozojë nxjerrjen e dëshmive;
- Sigurimi i parakushteve materiale-teknike për shënimin e rrjedhës së seancës kryesore, gjegjësisht përdorimi i teknikave bashkëkohore të regjistrimit të përcaktuara me LPP;
- Parimi i transparencës në gjykim dhe përmes njoftimit publik të vendit dhe kohës së gjykimit;
- Të përcaktohet mundësia për kontestimin e përkthimit në qoftë se pala dyshon se i njëjti është jo kompetent ose anshëm duke pasur parasysh kuptimin thelbësor për realizimin e gjykimit fer dhe të drejtë;
- Gjykata ka për detyrë të mbajë udhëzim për të drejtën e ankesës, si dhe për të drejtën për përgjigje të ankesës të cilën si garanci është përcaktuar me nenin 2 Protokollin 7 drejt Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

## 6. LITERATURA E PËRDORUR

Arnaudovski, Ljupço, prof dr. Analiza për Nevoja për ndjekjen e lëndëve gjyqësore nga lëmia e korrupsionit, Docent dr. Slagjana Taseva, Suzana Salium Koalicioni Të gjithë për gjykim të drejtë, Shkup viti 2007.

Bogdanovska, **Aleksandra** “Efikasiteti gjyqësor në luftën kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit” – Koalicioni Të gjithë për gjykim të drejtë, viti 2015  
[http://all4fairtrials.org.mk/wpcontent/uploads/2016/06/INL\\_Analiza\\_2015\\_MKD.pdf](http://all4fairtrials.org.mk/wpcontent/uploads/2016/06/INL_Analiza_2015_MKD.pdf)

Buzharovska, Gordana dhe të tjerë, “Testimi i kryqëzuar doracak për praktikues”- Shkup, OSBE 2010

Buzharovska, **Gordana** “Zgjidhja e fajësisë: doracak për praktikues” (Gordana Buzharovska, Majkëll G. Karnavas, Dejvid Rej) – Shkup: OSBE 2010

Commission Staff Working Document The Former Yugoslav Republic of Macedonia 2016 Report  
[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2016/20161109\\_report\\_the\\_former\\_yugoslav\\_republic\\_of\\_macedonia.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2016/20161109_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf)

Çalovska, Neda, mr. Golubovska, Jasmina, mr. Stojanovski, Vojislav, mr. Jovanoski Aleksander, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore në Republikës së Maqedonisë”, viti 2015

Deklarata universale për të Drejtat e Njeriut, Kombet e Bashkuara, viti 1948

“Doracak për Ligjin e Procedurës Penale,” Ministria e Punëve të Brendshme, Biroja e Qendrës për Siguri, Qendra për Trajnim, Shkup, 2012

Gogov, **Bogdanço, dr.** “Reforma e politikës penale ose diçka tjetër”, 1,02 Artikull shkencor i rishikuar УДК343.19.077.6.04(497.7),

Greva e administratës gjyqësore,  
[http://zsarm.com/read\\_more.php?un=151304dfdab76e1463da824883c7c079b4e3b2e1](http://zsarm.com/read_more.php?un=151304dfdab76e1463da824883c7c079b4e3b2e1)

Gjykim i drejtë, Doracak / Fair Trials Manual, Fondi për të drejtën humanitare Beograd 2001 (përkthim i Amnesty International Fair Trials Manual)

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut  
[http://www.echr.coe.int/Documents/Convention\\_MKD.pdf](http://www.echr.coe.int/Documents/Convention_MKD.pdf)), Këshilli i Evropës, viti 1950;

Kronologji e krizës politike në Maqedoni

Kushtetuta e RM, **Gazeta Zyrtare** бр.52, 22.11.1991  
<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/19D704B29EC040A1968D7996AA0F1A56.pdf>

Ligji i azilit dhe mbrojtjes së përkohshme, [www.pravdiko.mk/zakon-za-azil-i-privremena-zashtita/](http://www.pravdiko.mk/zakon-za-azil-i-privremena-zashtita/)

Ligji i caktimit të llojit dhe kohëzgjatjes së dënimit (Gazeta Zyrtare e RM nr.199/14)

Ligji i procedurës penale, Gazeta Zyrtare 150/2010 e datës 18.11.2010

Ndryshimet e personelit në Gjykatën Penale të Shkupit,  
<http://www.akademik.mk/kadrovski-promeni-vo-skopskiot-krivichen-sud/>

Nuredinoska, Emina, "Raport për vlerësimin e korrupsionit në Maqedoni" / [autorët Emina Nuredinoska Marija Sazdevski, Borjan Gjuzelov]. - Shkup: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN), 2014.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, viti 1966

Progress Report Macedonia 2015,  
[www.wbcrti.info/object/document/14557/attach/20151110\\_report\\_the\\_former\\_yugoslav\\_republic\\_of\\_macedonia.pdf](http://www.wbcrti.info/object/document/14557/attach/20151110_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf)

Rregullore për mënyrën e vlerësimit dënimin (Gazeta zyrtare No.64 / 14).

Shopova Ivanovska, Liljana, Gjykatës në Gjykatën e Apelit në Shkup, Dimitrievski, Zoran, Gjykatës në Gjykatën e Apelit në Shkup, Mariçiq, Momir, Anëtar i Këshillit të prokurorëve publik, Trajnim i avancuar për Ligjin e Ri për PP Modul: 3 Seanca Kryesore-Doracak - 2013

Takimi i pestë i Dialogut të anëtarësimit të nivelit të lartë midis Maqedonisë dhe Komisionit Evropian 18/09/2015

The former Yugoslav Republic of Macedonia: Recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues relating to the communications interception revealed in Spring 2015, [www.ec.europa.eu/enlargement/news\\_corner/news/news-files/20150619\\_recommendations\\_of\\_the\\_senior\\_experts\\_group.pdf](http://www.ec.europa.eu/enlargement/news_corner/news/news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf)

**Urgent Reform Priorities For The Former Yugoslav Republic Of Macedonia, June 2015,**  
[www.ec.europa.eu/enlargement/news\\_corner/news/news-files/20150619\\_urgent\\_reform\\_priorities.pdf](http://www.ec.europa.eu/enlargement/news_corner/news/news-files/20150619_urgent_reform_priorities.pdf)